

# Të dhënat kryesore

Banka Raiffeisen në Kosovë sh.a.			
Vlerat monetare janë në milionë euro	2016	2015	Ndryshimi
<b>Pasqyra e të ardhurave</b>	<b>1/1-31/12</b>	<b>1/1-31/12</b>	
Të ardhurat neto pas provizioneve	33.0	36.7	-10.0%
Të ardhurat neto nga tarifat bankare	9.6	9.2	4.3%
Të ardhurat neto nga vlerësimi I instrumenteve financiare në vlerë të drejtë	0.4	0.1	321.4%
Të ardhurat / shpenzimet nga tregtimi	0.6	0.4	42.3%
Të ardhurat tjera operative	1.5	0.3	325.7%
Shpenzimet e përgjithshme administrative	(25.8)	(26.0)	-0.7%
Fitimi para tatimit	19.3	20.8	-7.1%
Fitimi pas tatimit	17.0	18.6	-8.7%
Fitimet për aksion	N/A	N/A	N/A
<b>Bilanci i gjendjes</b>			
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	40.6	40.4	0.3%
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	495.7	450.6	10.0%
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	0.5	2.2	-76.8%
Depozitat nga klientët	725.0	675.2	7.4%
Ekuiteti (përfshi interesat jo-kontrolluse)	122.8	125.3	-2.0%
Gjithsej bilanci i gjendjes	879.5	831.4	5.8%
<b>Informatat vendore rregullative</b>			
Pasuritë e ponderuara sipas riskut B1	572.9	546.3	4.9%
Gjithsej fondet vetanake	117.5	118.0	-0.4%
Gjithsej kërkesa për fonde vetanake	68.7	65.6	4.9%
Raporti i mbulimit tepricë	71.0%	80.0%	-9.0 PP
Raporti i kapitalit kryesor (klasi i parë)	16.8%	17.4%	-0.6 PP
Gjithsej raporti I fondeve vetanake	20.5%	21.6%	-1.1 PP
<b>Performanca</b>			
Kthimi në ekuitet (KE) para tatimit	17.4%	17.7%	-0.3 PP
Kthimi në ekuitet (KE) pas tatimit	15.3%	15.8%	-0.5 PP
Koeficienti kosto/të ardhura	53.2%	53.5%	-0.3 PP
Kthimi në pasuri (KP) para tatimit	2.3%	2.6%	-0.3 PP
Raporti neto i provizionimit (Pasuritë mesatare të ponderuara sipas riskut B1 në librin e bankës)	0.8%	0.5%	0.3 PP
Koeficienti rrezik / fitime	9.3%	4.2%	5.1 PP
<b>Burimet</b>			
Numri i punëtorëve	711	693	2.6%
Zyrat e biznesit	50	50	0.0%

# Përmbajtja

---

Raport nga Bordi Mbikëqyrës	4
Report nga Bordi Menaxhues	5
Bordi Menaxhues i Kosovës	6
Struktura organizative	7
Visioni dhe misioni	8
Shkurtimisht mbi Raiffeisen Bank International	9
Bashkimi i RBI dhe RZB	10
Sektori bankar në Kosovë	12
Performanca dhe financat e Bankës Raiffeisen në Kosovë	14
Thesari, menaxhimi i pasurive dhe i detyrimeve	18
Segmentet e biznesit	20
Produktet dhe shërbimet bankare	22
Menaxhimi i rrezikut	23
Kanalet e distribuimit	26
Burimet njerëzore	27
Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia shoqërore e korporatës	29
Pasqyrat financiare	34
Adresat dhe kontaktet	80

# Raport nga Bordi Mbikëqyrës

Zonja dhe zotërinj,

Viti financiar 2016 dominohej nga dy çështje kryesore: së pari, mjedisi i tregut, i cili ka mbetur sfidues për shkak të nivelit shumë të ulët të normave të interesit dhe presioneve të vazhdueshme të larta rregullative dhe politike; së dyti, fillimi i procesit të vlerësimit të bashkimit të RBI dhe RZB.

Kërkesat për kapitalizim për bankat janë rritur në mënyrë të konsiderueshme pas krizës financiare të vitit 2008 dhe autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare rregulluese kanë ashpërsuar në mënyrë të konsiderueshme rregulloret. Muaji shkurt i vitit 2015 karakterizohet me zbatimin e programit të transformimit të dizajnuar për fuqizimin e bazës së kapitalit – ka synuar raportin e kapitalit të klasit të parë (CET1) prej së paku 12 përqind, një reduktim të kompleksitetit dhe një reduktim të konsiderueshëm të kostove. Me një normë CET1 (të ngarkuar plotësisht) prej 13.6 përqind më 31 dhjetor 2016, RBI ka arritur targetin e saj përpara afatit.

Pas një faze të gjerë vlerësimi, më 5 tetor 2016, Bordi Menaxhues dhe Bordi Mbikëqyrës i RBI dhe RZB miratuan në parim një rezolutë për bashkimin e RBI dhe RZB. Në mbledhjen e përgjithshme të jashtëzakonshme të RBI u aprovua bashkimi me RZB me shumicë votash më 24 janar 2017. Bashkimi hyn në fuqi pas futjes në regjistrin komercial, i cili pritet të ndodh më së largu deri në fund të muajit mars 2017.

Përparësitë e entitetit të bashkuar do të bazohen mbi arritjet paraprake. Këto përfshijnë historikun e krijuar në tregjet atraktive në rritje të vendeve të EQL, duke përfshirë pesë pozitat kryesore në treg në 9 nga gjithsej 14 tregjet, si dhe biznesin e qëndrueshëm në Austri. Fokusi do të mbetet në marrëdhëniet afatgjata me klientë në tregjet përkatëse vendore. Si bankë universale e orientuar në klientin, zgjidhjet për adresimin e nevojave të klientëve korporatë në bazë të qasjes në tregun vendor dhe rritjet të gjerë, së bashku me ofertën gjithëpërfshirëse për klientët me pakicë (retail) në EQL, luajnë një rol të rëndësishëm në fokusin e përgjithshëm.

Sa i përket Bankës Raiffeisen në Kosovë, në vitin 2016 është arritur një fitim neto prej 17 milionë euro, e cila gjeneroi një kthim në ekuitet pas tatimit prej 15.3 përqind. Banka vazhdoi të mbetet numër një në vend jo vetëm për sa i përket fitimit neto por gjithashtu edhe për një gamë të gjerë të kriterëve si pasuritë totale, kreditë neto, depozitat dhe numri i degëve. Viti 2016 ishte gjithashtu vit i fokusit të Bankës në rritjen e përdorimit të kanaleve alternative, e që ka regjistruar zhvillime pozitive.

Do të doja të shfrytëzojë mundësinë të falënderoj punonjësit e Bankës Raiffeisen në Kosovë për punën e tyre të palodhshme dhe përpjekjet e vazhdueshme për t'iu shërbyer klientëve dhe për të sjellë përfitime për të gjithë Grupin Raiffeisen.

Në emër të Bordit Mbikëqyrës,



**Helmut Breit**  
Kryesues i Bordit Mbikëqyrës



# Raporti nga Bordi Menaxhues

2016 ishte një tjetër vit i shkëlqyer për Bankën Raiffeisen Sh.A. në Kosovë. Mjedisi makro ekonomik i vendit ishte më i mirë se në shumë vende të tjera në Evropën Juglindore dhe bruto produkti vendor i llogaritur për Kosovën ishte mbi 3 përqind, që ka qenë vazhdimisht i tillë për disa vite me radhë. Kjo ka kontribuar në një tjetër vit të shkëlqyer për Bankën, me një fitim neto pas tatimit prej 17 milionë euro, që ishte veçanërisht i kënaqshëm duke pasur parasysh provizionet shtesë të pabuxhetuara prej 1.3 milionë euro, të cilat janë marrë para hyrjes në fuqi së IFRS9 më 1 janar 2018.

Rritja e kredive në të gjitha segmentet tona të klientëve ishte mbresëlënëse dhe edhe pse kemi pasur një qasje të matur dhe të ndjeshme në kreditim, portofolio jonë u rrit për 45.1 milionë euro, në 495.7 milionë euro në fund të vitit, duke paraqitur një rritje prej 10 përqind në vitin 2015. Qasja jonë e matur ndaj kreditimit tash e disa vite ka rezultuar në një raport të shkëlqyer të kredive joperformuese prej 6.3 përqind në fund të vitit 2016 dhe sistemi bankar në Kosovë ka raportin më të ulët të kredive joperformuese në Evropën Juglindore. Depozitat tona u rritën për 7 përqind në 725 milionë euro dhe kjo tregon qartë besimin që klientët tanë kanë në kompaninë tonë dhe kënaqshmërinë e tyre me shërbimin tonë ndaj klientëve. Menaxhimi i kostove dhe efikasiteti i përmirësuar kanë vazhduar të merren parasysh në vitin 2016 dhe raporti kosto/të ardhura pati një rënie të lehtë nga 53.5 përqind në vitin 2015 në 53.2 përqind në vitin 2016.


Përqendrimi ynë në rritjen e përdorimit të kanaleve alternative ka rezultuar në rezultate pozitive dhe kemi procesuar 480 mijë transaksione individuale përmes E-Banking, që ishte një rritje prej 26 përqind në krahasim me vitin 2015. Përdorimi i shërbimeve tona mobile bankare u rrit për 104 përqind dhe pagesat nëpërmjet këtij kanali u rritën për 70 përqind. Ne gjithashtu kemi procesuar mbi 1.2 milionë transaksione në терминаlet tona të pikave të shitjes, që ishte një rritje prej 20 përqind në krahasim me vitin 2015. Kemi pasur 4.6 milionë transaksione në bankomatët tanë, që është një rritje prej 15 përqind në krahasim me vitin 2015. Në segmentet tona afariste të ndërmarrjeve të vogla (NV) dhe të korporatave ka vazhduar trendi pozitiv i përdorimit të rritur. Gjatë vitit, 287 mijë transaksione E-Banking janë procesuar, që paraqesin 73 përqind të të gjitha pagesave të procesuara, një rritje kjo prej 11 përqind në krahasim me vitin 2015. Në fillim të vitit kemi prezantuar një shërbim inovativ të pagesës me SMS për pagesat doganore, që ka krijuar një përvojë tërësisht të ndryshme të klientëve, dhe është pritur shumë mirë në treg. Gjatë vitit janë procesuar më shumë se 238 milionë euro pagesa doganore, që paraqet 73 përqind në korporatë dhe 35 përqind në NV, të të gjitha pagesave doganore të procesuara.

Shërbimi për klientë vazhdoi të jetë një përparësi e rëndësishme konkurruese dhe si gjithmonë, ne jemi fokusuar në përmirësimin e kënaqshmërisë së klientëve me të gjitha produktet dhe shërbimet tona. Kemi bërë investime të konsiderueshme në teknologji dhe trajnimin e punonjësve për të plotësuar dhe tejkaluar pritjet e klientëve tanë dhe për të siguruar se ofrojmë përvoja pozitive dhe të paharueshme në çdo ndërveprim. Kultura e përqendruar drejt klientëve tanë është një përparësi e madhe dhe është baza që na shërben për zhvillimin e çdo gjëje për të plotësuar kërkesat dhe pritjet e klientëve tanë. Duke qenë aktiv në rrjetet sociale, ne gjithashtu kemi arritur që të qëndrojmë afër klientëve tanë dhe të angazhohemi përmes komunikimeve dhe përgjigjeve relevante dhe motivuese ndaj kërkesave dhe pyetjeve të tyre.

Në fushën e përgjegjësisë sociale, ne kemi adoptuar dhe miratuar standardet IFC dhe udhëzimet për të menaxhuar rrezikun mjedisor dhe social dhe kjo politikë është aplikuar në nivel të brendshëm nga fillimi i vitit 2016. Ne kemi vazhduar mbështetjen për sektorin e shëndetësisë duke dhuruar pajisje në gjashtë spitale rajonale në shumën prej 50,000 euro. Projektet tona përfshinin edhe bashkëpunimin me fondin e bamirësisë të H. Stepic CEE Charity duke mbështetur më tej qendrën e edukimit për fëmijët e komuniteteve pakicë në Fushë Kosovë (37,000 euro). Një tjetër iniciativë e ndërmarrë në gjysmën e dytë të vitit 2016 ishte adaptimi i një hapësire në qendrën më të madhe tregtare në Kosovë për promovimin e punimeve artistike të artistëve të rinj. Kjo hapësirë filloi të shfrytëzohet që nga muaji tetor i vitit 2016 dhe do të mbetet e hapur për një vit, ku çdo muaj një artist i ri promovon punën e tij apo saj.

Së fundi, në emër të Bordit Menaxhues do të dëshiroja të falënderoj të gjithë punonjësit për një vit tjetër të shkëlqyer. Asnjëra nga këto nuk do të ishte e mundur pa aftësitë, angazhimin dhe dedikimin e tyre.

Në emër të Bordit Menaxhues,



**Robert Wright**  
Kryesues i Bordit Menaxhues



# Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë



**Robert Wright**

Kryesues i Bordit  
Menaxhues




**Shukri Mustafa**

Anëtar i Bordit  
Menaxhues



**Iliriana Toçi**

Anëtare e Bordit  
Menaxhues




**Johannes Riepl**

Anëtar i Bordit  
Menaxhues

# Struktura organizative e Bankës Raiffeisen në Kosovë

Deri më 31 dhjetor 2016



\*Auditori i brendshëm i raporton drejtpërdrejt Komitetit të Auditimit të Bordit Mbikqyrës

# Vizioni dhe misioni i Bankës Raiffeisen në Kosovë

**Vizioni**

Të jetë banka kryesore dhe universale në Kosovë.

**Misioni**

Të zhvillojë marrëdhënie afatgjata me klientë duke ju ofruar një gamë të gjerë të produkteve konkurruese dhe shërbime të një standardi të lartë.

Të jetë punëdhënësi më i mirë në Kosovë.



# Shkurtimisht mbi Raiffeisen Bank International

Raiffeisen Bank International AG e konsideron Evropën Qendrore dhe Lindore (përfshirë Austrinë) si tregun e saj. Për mbi 30 vite, RBI ka operuar në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL), ku sot mban një rrjet të ngushtë të bankave, kompanive të lizingut dhe ofruesve të shumtë të specializuar të shërbimeve financiare. Si bankë universale, RBI renditet në mesin e pesë bankave kryesore në disa shtete. Ky rol është i përkrahur nga brendi Raiffeisen, që është një nga brendet më të njohura në rajon. RBI ka pozicionuar veten në EQL si grup plotësisht i integruar i shërbimeve bankare për korporata dhe shërbimeve retail (individëve), me ofertë të plotë të produkteve.

Në EQL, në fund të vitit 2016, rreth 46,000 punonjës të RBI-së u kanë shërbyer rreth 14.1 milionë klientëve në rreth 2,500 njësi të biznesit. Në Austri, RBI është një nga bankat kryesore të korporatave dhe të investimeve. Ajo kryesisht u shërben klientëve austriakë, por edhe ndërkombëtarë si dhe korporatave të mëdha ndërkombëtare që veprojnë në EQL. Në përgjithësi, RBI ka të punësuar rreth 49,000 punëtorë dhe ka pasuri totale prej përafërsisht 112 miliardë euro.

Raiffeisen Zentralbank Österreich (RZB AG) është themeluar në vitin 1927 si "Girozentrale der österreichischen Genossenschaften" dhe në atë kohë ka shërbyer si qendër për balancimin e likuiditetit për kooperativat bujqësore të Austrisë, siç është paraparë nga reformuesi social Friedrich Wilhelm Raiffeisen.

RZB AG ka pasur një nga rrjetet më të mëdha bankare në EQL nëpërmjet filialës së saj, Raiffeisen Bank International (RBI AG), e cila është listuar në bursë që nga viti 2005. Në fund të vitit 2016, RZB AG mbajti përafërsisht 60.7 përqind të aksioneve të RBI, ndërsa aksionet e mbetura janë në shitje të lirë. RZB AG fillimisht ka qenë në pronësi të tetë bankave rajonale Raiffeisen dhe ka shërbyer si institucion qendror i tyre në pajtim me Austrian Banking Act (BWG). Pas bashkimit ndërmjet RZB AG dhe RBI AG, në mënyrë retroaktive nga data 30 qershor 2016, RBI AG do të marrë rolin e institucionit qendror të RBG përmes suksesionit universal.

# Bashkimi i RBI dhe RZB

## Arsyetimi i bashkimit

Mjedisi i tregut për banka ka ndryshuar shumë në vitet e fundit. Kërkesat për kapitalizim për bankat janë rritur në mënyrë të konsiderueshme pas krizës financiare të vitit 2008 dhe autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare rregulluese kanë ashpërsuar në mënyrë të konsiderueshme rregulloret. Edhe pse kjo ka ndikuar në dobi të stabilitetit të përgjithshëm të sistemit financiar evropian, në të njëjtën kohë, barra administrative dhe kompleksiteti për bankat është rritur ndjeshëm. Kërkesat më strikte dhe stres testet e rregullta të bankave, për shembull, kërkojnë përgatitje gjithëpërfshirëse dhe resurse të lidhura (tie up). Përveç kësaj, ka pasur edhe ngarkesa të tjera si taksa bankare në shumë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore. Këto nuk kontribuojnë në stabilizimin e sistemit financiar, por ndikojnë negativisht në resurset bankare, duke zvogëluar në këtë mënyrë potencialin për fuqizimin e ekuitetit përmes gjenerimit të brendshëm.

Në këtë kontekst, Borxhi Menaxhues beson më shumë se kurrë se ka përgjegjësinë për vlerësimin e vazhdueshëm të pozitës dhe perspektivave të kompanisë, si dhe për identifikimin e opsioneve për përshtatjen me mjedisin e ndryshuar të tregut dhe sfidat rezultuese për pozicionim optimal në të ardhmen. Gjithashtu pjesë e këtyre konsideratave ishte edhe vlerësimi i bashkimit të RBI dhe RZB dhe përfitimet potenciale që rezultojnë për të gjithë Grupin.

## Përparësitë e bankës së kombinuar

Objektivat kryesorë të transaksionit përfshijnë, në njëërën anë, ruajtjen e modelit të dëshmuar të biznesit dhe, në anën tjetër, pozicionimin optimal të organizatës për sfidat e lartpërmendura. Fokusi kryesor është në tri çështje:

- Së pari, duhet të përmirësojë kapitalizimin e Grupit nga perspektiva rregullative. Planifikimi dhe ndarja e kapitalit duhet të optimizohen. Përveç kësaj, zbritja e interesit minoritar për bankën e kombinuar duhet të eliminohet dhe të ruhet kapitali. RZB i është dashur të zbresë interesat minoritar pas miratimit të Bazel III.
- Së dyti, transparenca e brendshme dhe e jashtme e Grupit do të rritet: harmonizimi i interesave të aksionarëve dhe kërkesave rregullative do të bëhen shumë më të thjeshta. Në të njëjtën kohë përmirësohet transparenca për të gjithë akterët duke thjeshtësuar strukturën e Grupit, e cila paraprakisht ka qenë shumë komplekse.
- Së treti, bashkimi ka ndikim pozitiv në politikat e qeverisjes korporative: strukturat më të pakta organizative dhe qeverisëse lehtësojnë procese më të fokusuara dhe efikase të vendimmarrjes në organizatë. Do të eliminohen funksionet e mëhershme mbivendosëse ndërmjet dy kompanive.

Përparësitë e bankës së kombinuar bazohen mbi arritjet paraprake. Këto përfshijnë prezencën gjeografike në tregjet atraktive në rritje të EQL, me pesë pozitat kryesore në treg në 9 nga gjithsej 14 tregje, si dhe biznesin e qëndrueshëm në Austri. Fokusi do të mbetet në marrëdhëniet afatgjata me klientët në tregjet përkatëse vendore. Si bankë universale e orientuar në klientin, zgjidhjet për adresimin e nevojave të klientëve të korporatës në bazë të qasjes në tregun vendor dhe rrjetit të gjerë bankar, së bashku me ofertën gjithëpërfshirëse shumë-kanalëshe për klientët retail në EQL, luajnë një rol të rëndësishëm në fokusin e përgjithshëm.

Kontrolli i kostove do të mbetet prioritet i lartë dhe struktura më e efektshme organizative do të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës.

## Ecuria e bashkimit

Më 10 maj 2016, Bordet Menaxhuese të RBI dhe RZB vendosën të shqyrtojnë bashkimin e RBI dhe RZB. Objektivat e bashkimit duhet të ishin thjeshtësimi i strukturës së korporatës dhe përshtatja e Grupit me kërkesat e rritura rregullative.

Pas një faze gjithëpërfshirëse të vlerësimit, më 5 tetor 2016, Bordet Menaxhuese dhe Mbikëqyrëse të RBI dhe RZB miratuan në parim rezolutën për bashkimin e RZB dhe RBI. Në lidhje me këtë, u përcaktuan edhe gamat preliminare të vlerësimit për entitetet që bashkoheshin. RZB, si kompani transferuese, do të bashkohet me RBI, e cila do të jetë kompani e re e bashkuar përmes suksesionit universal duke transferuar të gjitha pasuritë e RZB që nga data 30 qershor 2016 dhe në bazë të bilancit përmbyllës të RZB të 30 qershor 2016, me një rritje të kapitalit për RBI. Banka e kombinuar do të operojë me emrin Raiffeisen Bank International AG, siç ka qenë paraprakisht për RBI dhe aksionet e RBI do të vazhdojnë të listohen në bursën e Vjenës.

Dokumentet e nevojshme për të votuar për bashkimin në takimin e jashtëzakonshëm të përgjithshëm janë publikuar më 21 dhjetor 2016, pas publikimit të raportit final të këmbimit më 16 dhjetor 2016 dhe përfundimit të shqyrtimeve ligjore nga auditori për bashkim dhe Bordet Mbikëqyrëse të entiteteve që bashkohen. Më 23 dhe 24 janar 2017, RZB dhe RBI mbajtën takime të përgjithshme të jashtëzakonshme për të miratuar rezolutat për bashkimin. Për miratimin e rezolutave për bashkim nevojitej shumica e votave të tri të katërtave të kapitalit aksionar prezent. Kjo shumicë ishte tejkuluar nga një margjinë e gjerë në të dyja rastet.

Takimi i përgjithshëm i jashtëzakonshëm i RBI mund të shikohet online në [www.rbinternational.com](http://www.rbinternational.com) → Investor Relations → Presentations & Webcasts. Bashkimi përfshihet në regjistrin komercial më 18 mars 2017.

Raporti i përcaktuar i këmbimit është mbështetur nga vlerësimet relative të kompanive të realizuara nga dy vlerësues të njohur ndërkombëtarisht, në përputhje me ligjin e Austrisë për bashkim; korrektësia e raportit të këmbimit është verifikuar edhe nga një auditor i pavarur për bashkim i emëruar nga gjykata, gjithashtu një vlerësues i njohur (pranuar). Për të kompensuar aksionarët e RZB për aksionet e tyre në bankë, RBI do të emetojë aksione të reja, duke rritur në këtë mënyrë numrin total të aksioneve të saj nga 292,979,038 në 328,939,621.

# Sektori bankar në Kosovë


Shënim: Të dhënat janë të bazuara në publikimet zyrtare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë sektori kryesor që ka kontribuar në stabilitetin dhe zgjerimin e aktiviteteve financiare në vend. Ai gjithashtu mbizotëron sistemin financiar të Kosovës, duke kontribuar në 68 përqind të gjithë pasurive. Dhjetë banka të licencuara kanë operuar në treg në vitin 2016, nga të cilat, tetë janë në pronësi të huaj. Pasuritë e bankave të huaja përbëjnë 90 përqind të gjithë pasurive dhe 92 përqind të gjithë kapitalit të bankave në treg.

Gjithë pasuritë e sektorit bankar arritën në 3.64 miliardë euro më 31 dhjetor 2016 (2015: 3.39 miliardë euro). Rritja e gjithë pasurive në vitin 2016 ishte 7.4 përqind dhe është më e lartë se rritja e vitit të mëparshëm për 6.3 përqind. Rritja e gjithë pasurive të bankave është mbështetur kryesisht nga rritja e kredive dhe paradhëniet për konsumatorët, e cila vazhdon të jetë kategoria kryesore e pasurive.

Aktiviteti kreditues i bankave në vitin 2016 ka vazhduar të rritet me një normë më të shpejtë se sa në vitin e kaluar. Gjithë kreditë dhe paradhëniet arritën vlerën prej 2.23 miliardë euro (2015: 2.02 miliardë euro) e cila është një rritje vjetore prej 10.4 përqind në krahasim me 7.3 përqind në vitin 2015.

Kjo ngritje në rritje u shkaktua nga rënia e normave të interesit në treg, kushteve të përgjithshme të favorshme të kreditimit



nga bankat dhe rritja e kërkesës për kredi. Kontributi më i madh në rritjen e kredive ishte nga kreditë dhe paradhëniet si për bizneset ashtu edhe individët. Kreditë dhe paradhëniet për individë vazhduan të kenë ndikim të rëndësishëm në rritjen e totalit të portofolios së kredisë për të dytin vit radhazi. Rritja kryesore në kreditë dhe paradhëniet për individë erdhi nga kreditë individuale të konsumatorëve që ishte më e lartë se sa kërkesa për kredi hipotekare, e cila dëshmoi një trend më të ngadalshëm të rritjes në vitin 2016.

Përqindja e alokimit të kredive dhe paradhëniet si më 31 dhjetor 2016 ishte 64 përqind për korporatat jo-financiare dhe 36 përqind për individët. Përqendrimi në sektorë ekonomik i kredive dhe paradhëniet të reja për biznese vazhdoi të dominohet nga sektori tregtar me një pjesëmarrje të përgjithshme prej 50.2 përqind, e ndjekur nga prodhimi me 12.0 përqind dhe ndërtimi me 7.4 përqind. (Burimi: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë, Nr 16, Tremujori III / 2016).

Kreditë e reja të akorduara bizneseve në vitin 2016 shënuan një rënie prej 15 përqind në krahasim me vitin paraprak. Ndërsa kreditë e reja të akorduara individëve në vitin 2016 u rritën për 11 përqind në krahasim me vitin paraprak, ku rritja më e madhe është shënuar në kreditë e reja të konsumatorëve të cilat u rritën për 18 përqind në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

Investimet e sektorit bankar në bono qeveritare dhe bono të thesarit arritën në 510.3 milionë euro në vitin 2016 (2015: 473,3 milionë euro), një rritje kjo prej 8 përqind. Rritja është më e ngadalshme se një vit më parë, kur rritja vjetore ishte 23 përqind.

Depozitat e klientëve vazhdojnë të jenë kontribuuesi kryesor në financimin e aktiviteteve bankare. Më dhjetor 2016, depozitat e klientëve përbënin 80 përqind të gjithë depozitave të sektorit bankar. Një mbështetje e madhe në financimin nga depozitat lokale, sidomos nga individët privatë e bën këtë mënyrën më të mirë për financim krahasuar me opsionet tjera dhe gjithashtu është imune ndaj luhatjeve ndërkombëtare në tregjet financiare.


Totali i depozitave në sektorin bankar arriti në 2.9 miliardë euro. Një rritje vjetore prej 7.2 përqind, e cila është më e madhe kur krahasohet me normën e rritjes prej 6.5 përqind në vitin 2015. Struktura e depozitave është e dominuar nga depozitat nga individët privatë duke përbërë 73 përqind të depozitave totale. Depozitat e individëve vazhduan të jenë kontribuuesi më i madh në rritjen e depozitave, të cilat arritën një rritje vjetore prej 8 përqind (6 përqind në vitin 2015).

Struktura e depozitave në banka ka ndryshuar në vitet e fundit, pasi që normat e interesit kanë shënuar ulje historike. Si

rezultat, ka pasur më shumë depozita në llogaritë rrjedhëse dhe më pak depozita të afatizuara dhe llogaritë e kursimit. Më 31 dhjetor 2016, depozitat pa afat përbënin 52.6 përqind të totalit të depozitave, të përcjellura nga depozitat me afat me 23.9 përqind dhe depozitat e kursimit me 23.5 përqind.

Norma mesatare e interesit për depozita ka mbetur stabile në vitin e kaluar dhe në të njëjtën normë si në vitin 2015 me 1.2 përqind. Norma mesatare e interesit për depozitat individuale ishte 1.0 përqind, ndërsa për bizneset ishte 1.6 përqind.

Norma e interesit për kredi ka qenë në rënie për disa vite tashmë. Në vitin 2016, norma mesatare efektive e interesit të kredive ka rënë nga 7.7 përqind në 7.2 përqind. Normat e interesit për kredi kanë rënë si për bizneset ashtu edhe për individët. Norma mesatare e interesit për bizneset më 31 dhjetor 2016 ishte 6.8 përqind nga 7.4 përqind më 31 dhjetor të vitit 2015. Norma mesatare e interesit për individët gjithashtu ka shënuar rënie gjatë vitit 2016 nga 8.4 përqind në vitin 2015 në 7.9 përqind në fund të vitit 2016.



Në vitin 2016, sektori bankar nuk ka arritur rezultate të mira si në vitin paraprak, i cili ka qenë një arritje rekord për sektorin bankar në Kosovë. Më 31 dhjetor 2016, fitimi neto i sektorit bankar ishte 75.5 milionë euro (2015: 94.7 milionë euro). Të ardhurat nga interesi ishin për 4 përqind më të ulëta në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015. Kjo është ndikuar edhe nga rënia e normave të interesit në treg për kreditë dhe paradhëniet për klientët.

Shpenzimet e përgjithshme të sektorit bankar ishin më të larta në vitin 2016 për 8.4 përqind. Kjo është ndikuar pjesërisht nga shpenzimet më të larta për provizionet për humbjet nga kreditë duke marrë parasysh faktin se vitin e kaluar sektori bankar kishte bilanc pozitiv për shkak të lëshimit të rezervave të provizionit të grumbulluara më herët. Pra, shpenzimet e bankave shënuan rritje në vitin 2016 përkundër asaj se shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të sektorit bankar shënuan rënie prej 7 përqind.




Të ardhurat më të ulëta të sektorit bankar gjithashtu kanë ndikuar një numër të normave të performancës në vitin 2016. Kithimi nga pasuritë mesatare ka rënë në 2.2 përqind (2015: 2.9 përqind) dhe kithimi nga kapitali mesatar ka rënë në 18.5 përqind nga 26.4 përqind në vitin 2015. Raporti kredi-depozita ishte 77 përqind më 31 dhjetor 2016 nga 74.8 përqind më 31 dhjetor 2015. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (kapitali rregullativ/asetet e peshuara ndaj rrezikut) ishte 17.9 përqind nga 19 përqind sa ishte më 31 dhjetor 2015 dhe raporti i kredive ndaj depozitave i sektorit bankar ishte 77.0 përqind më 31 dhjetor 2016.

Në vitin 2016, është përmirësuar raporti i kredive joperformuese dhe në të njëjtën kohë është përmirësuar edhe raporti i mbulimit të provizioneve për kreditë joperformuese. Më 31 dhjetor 2016 raporti i kredive joperformuese ndaj totalit të kredive kishte rënë në 4.9 përqind (2015, 6.2 përqind). Përveç kësaj, raporti i mbulimit të kredive joperformuese është përmirësuar nga 115 përqind më 31 dhjetor 2015 në 126.5 përqind më 31 dhjetor 2016.

# Performanca dhe rezultatet financiare të Bankës Raiffeisen në Kosovë

Shënim: Analizat e tregut janë bazuar në rezultatet preliminare të botuara nga bankat komerciale, të përgatitura sipas rregullave të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës.


Totali i pasurive të Bankës Raiffeisen në Kosovë Sh.A më 31 dhjetor 2016 ishte 879.5 milionë euro. Kjo paraqet një rritje prej 5.8 përqind në krahasim me vitin paraprak (2015: 831.4 milionë euro). Përqindja e pjesës së tregut të totalit të pasurive të Bankës Raiffeisen në Kosovë ka qenë 24 përqind (2016: 26 përqind).



Struktura e pasurive të Bankës Raiffeisen në Kosovë vazhdon të dominohet nga kreditë dhe paradhëniet për klientët. Më 31 dhjetor 2016, 56 përqind e totalit të pasurive ishin të përqendruara në kredi dhe paradhënie për klientët pas provizionimit për humbjet nga kreditë. Kjo pasohet me 24 përqind në letrat me vlerë të investimeve.

Letrat me vlerë të investimeve përfshijnë investimet në bonot qeveritare të vendeve të BE-së dhe SHBA, si dhe bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Kosovës.


Investimet në letra me vlerë në vitin 2016 kanë rënë për 9 përqind. Investimet e përgjithshme në letra me vlerë më 31 dhjetor 2016 ishin 207.7 milionë euro. Investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës kanë qenë 42 milionë euro (2015: 43 milionë euro) ndërsa investimet në obligacionet qeveritare të shteteve tjera të OBZHE-së ishin 168.8 milion euro (2015: 186 milionë euro).



Gjithsej kreditë bruto dhe paradhëniet e Bankës Raiffeisen në Kosovë më 31 dhjetor 2016 ishin 514.4 milionë euro (2015: 472.2 milionë euro). Pjesa e tregut në kredi dhe paradhënie më 31 dhjetor 2016 ishte 22 përqind (2015: 23 përqind).



Banka Raiffeisen në Kosovë ka ndarë edhe rezerva për humbjet nga kreditë në bazë të politikave të rrezikut kreditor. Rezervat për humbje nga kreditë arrijnë në 18.7 milionë euro (2015: 21.6 milion euro). Këto rezerva janë për portfolion kreditorë specifikiisht të vlerësuar dhe të vlerësuar sipas portfolios kreditorë dhe pasqyrojnë vlerësimin e rrezikut të Bankës Raiffeisen në Kosovë për portfolion kreditorë më 31 dhjetor 2016.

Bilanci i provizioneve është më i ulët se një vit më parë dhe kjo është si rezultat i përmirësimit të raportit të kredive joperformuese të Bankës.



Gjithsej depozitat e klientëve janë rritur në 725 milionë euro më 31 dhjetor 2016 nga 675.2 milionë euro më 31 dhjetor 2015. Kjo është një rritje prej 7 përqind.


Gjenerimi vendor i financave gjithashtu ka kontribuar në drejtim të stabilitetit më të madh në sektorin bankar dhe ka ulur ndikimin e ndonjë paqëndrueshmërie në tregjet ndërkombëtare.



Kontribuesi më i madh në depozitat nga klientët ishin llogaritë rrjedhëse me një pjesëmarrje prej 76 përqind, një rritje nga 69 përqind sa ishin në vitin 2015. Llogaritë e kursimeve bëjnë pjesë me 21 përqind në depozitat e përgjithshme bankare të klientëve. Depozitat e afatizuara nga klientët përbëjnë vetëm 3 përqind të bazës së përgjithshme të depozitave. Rritja e bilanceve të llogarive rrjedhëse mund të shpjegohet edhe me rënien e tregut të normave të interesit të llogarive të kursimit dhe depozitave të afatizuara në vitet e fundit.

Struktura e detyrimeve të Bankës Raiffeisen në Kosovë është dominuar nga depozitat e klientëve dhe i njëjti rast vlenë edhe për tregun në Kosovë

Në vitin 2016, kapitali aksionar i Bankës Raiffeisen në Kosovë ishte 63 milionë euro. Kapitali i përgjithshëm më 31 dhjetor 2016 ishte 122.8 milionë euro (2015: 125.3 milionë euro) duke përfshirë edhe 59.9 milionë euro në formë të fitimeve të mbajtura. Raiffeisen Bank në Kosovë ka paguar një dividendë nga fitimet e saja të mbajtura në vitin 2016 në vlerë prej 19.5 milionë euro.



Kjo pagesë nuk është reflektuar në vlerën e kapitalit të përgjithshëm e as në kërkesat për kapitalin rregullator. Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të jetë e mirë-kapitalizuar, e që është reflektuar edhe në raportet e vitit 2016 të kapitalit rregullator të Klasit 1 ndaj raportit të pasurive totale të peshuara ndaj rrezikut prej 16.8 përqind (kërkesa ligjore është 8 përqind) dhe një raport të kapitalit total (duke përfshirë edhe Klasin 2) ndaj pasurive të peshuara ndaj rrezikut prej 20.5 përqind (kërkesa ligjore është 12 përqind). Në llogaritjen e kapitalit të Klasit 2 Banka e ka përfshirë shumën prej 19 milionë euro të borxhit të varur me një maturim fillestar prej dhjetë vjetësh. Kërkesat të mësipërme të kapitalit janë llogaritur në përputhje me rregulloren e BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe rregullave të tjera rregullative dhe rregulloreve të aplikueshme.





Të ardhurat neto pas tatimit në vitin 2016 ishin 17 milionë euro (2015: 18.6 milionë euro). Ky rezultat është llogaritur në bazë të pasqyrave financiare sipas SNRF, që janë bashkëngjitur në këtë raport. Banka Raiffeisen në Kosovë gjithashtu harton raporte financiare në bazë të SNRF-ve, që pasqyrojnë kërkesat shtesë nga rregulloret e Bankës Qendrore dhe këto raporte dërgohen në Bankën Qendrore dhe gjithashtu publikohen çdo tremujor në faqen e internetit të Bankës Raiffeisen në Kosovë, si dhe në gazetat e përditshme vendore.

Të ardhurat e Bankës Raiffeisen në Kosovë dominohen fuqishëm nga të ardhurat e gjeneruara nga kreditë dhe paradhëniet për klientët lokalë. Të ardhurat nga interesi mbi kreditë, paradhëniet dhe letrat me vlerë vazhdojnë të jenë burimi kryesor i të ardhurave pavarësisht normave për kredi në rënie në treg, si dhe rendimenteve shumë të ulëta dhe nganjëherë negative në bonot e lëshuara nga qeveritë e OBZHE-së. Kjo është kompensuar pjesërisht nga normat në rënie për depozitat bankare nga klientët.

Në vitin 2016, Banka ishte në gjendje të gjenerojë më shumë të ardhura nga tarifat dhe komisionet të cilat janë rritur me 26 përqind në vitin 2016, edhe pse shpenzimet korresponduese për tarifa dhe komisionet gjithashtu janë rritur duke kundër-balancuar një pjesë të kësaj rritjeje.

Gjatë vitit 2016, Banka gjithashtu ka vërejtur një efekt të dukshëm nga ndryshimet në mjedisin ligjor me licencimin e përmbaruesve privatë. Ajo ka arritur të ekzekutojë një numër të rasteve të pazgjidhura shumë më shpejtë se më parë. Kjo ka rezultuar në shitje më të shpejtë të aseteve të riposeduara të Bankës dhe si rezultat, Banka ka të ardhura më të larta në pozicionin të ardhura të tjera në vitin 2016.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative më 31 dhjetor 2016 ishin 25.8 milionë euro (2015: 26 milionë euro). Raporti të ardhura-kosto ishte 53.2 përqind (2015: 53.5 përqind). Kjo tregon një përmirësim të vogël në efikasitet. Kostot e personelit gjithashtu përfshijnë kostot e ndërlidhura me personelin, të tilla si për trajnim dhe zhvillim tjetër profesional. Këto kosto kanë vazhduar të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve operative sepse Banka Raiffeisen në Kosovë e konsideron shumë të rëndësishme investimin në zhvillimin profesional të personelit.



# Theuari, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve

## Menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve

Viti 2016 ishte vit i suksesshëm sa i përket mbledhjes dhe konsolidimit të depozitave. Banka Raiffeisen në Kosovë ka arritur të rrisë edhe më tej pozicionin e saj të depozitave kryesore. Duke u bazuar në rritjen e besimit në sistemin financiar, veçanërisht brendin e Bankës Raiffeisen në Kosovë, likuiditeti i bankës ka mbetur në nivel të qëndrueshëm, duke i ulur kështu kostot e financimit vit pas viti.

Pasuritë e thesarit/menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve kanë rënë nga 341 milionë euro në vitin 2015 në 333 milionë euro në fund të vitit 2016. Kreditë bruto të Bankës tregojnë nivele të mjaftueshme të likuiditetit me afër 40 përqind të bilancit të gjendjes. Në vitin 2016, Banka ka shënuar një rritje në depozitat e biznesit me rreth 50 milionë euro dhe 45 milionë euro në pasuritë e kredive të biznesit të klientëve.

Menaxhimi i kujdesshëm i pasurive dhe detyrimeve bëri të mundur që Banka ta mbajë koston më të ulët të fondeve në treg, që nga ana tjetër mundësoi norma më të ulëta të kredive. Në masë të madhe, ulja e shpenzimeve të interesit është arritur përmes modelimit sasior (kuantitativ) të menaxhimit të pasurive dhe detyrimeve. Banka përdor modelimin sasior për të matur pandryshueshmërinë e depozitave të klientëve, për pasuritë dhe detyrimet e saja që nuk maturojnë, si për qëllime të rrezikut të normës së interesit, ashtu edhe për qëllime të rrezikut të likuiditetit, si për klientët retail ashtu edhe ata korporatë.

Burimet e financimit të Bankës ishin nga depozitat e qëndrueshme të klientëve retail në shumën prej 84 përqind të totalit të depozitave, që tregon për një raport shumë të lartë të pandryshueshmërisë. Efekti i përbashkuar i një pozicioni të likuiditetit të lartë, dhe një pozicioni i pandryshueshmërisë së lartë kanë krijuar një pozitë të qëndrueshme të likuiditetit. Vlera e pikëve bazë të normave të interesit (BPV) në vitin 2016, ka treguar një pozitë mesatare të BPV prej rreth 20,000. Marzhi neto i interesave ka rënë edhe më tej në vitin 2016 në rreth 4.25 përqind për shkak të rritjes së likuiditetit dhe normave më të ulëta të interesit të kredisë.

## Letrat me vlerë të qeverisë

Nga gjithsej 333 milionë euro të pasurive të thesarit, portofolio e bonove të Bankës Raiffeisen në Kosovë në letrat me vlerë të huaja dhe vendore të qeverisë është rritur në 208 milionë euro në fund të vitit 2016. 80 përqind e portfolios janë letra me vlerë qeveritare të shkallës së investimeve të cilësisë së lartë të OBZHE-së, dhe pjesa e mbetur i është alokuar ekspozimit në Kosovë.

Letrat me vlerë të qeverisë në fund të vitit arritën një mesatare në kthimin aktual negativ prej 0.28 përqind dhe një kohëzgjatje të modifikuar prej 0.78 vite, ku kthimi negativ i instrumenteve të OBZHE-së është kompensuar pothuajse tërësisht nga normat e kthimit pozitiv të atyre kosovarë, por me kohëzgjatje trefish më të lartë. Duke pasur parasysh se normat historike të kthimit në blerje ishin shumë më të mira, kjo rezultoi në përfitime të përmirësuara të vlerësimit për instrumente me vlerë të drejtë, që është 86 përqind e portfolios.

Rating	Allocation
Aaa	28%
Aa1	21%
Aaa	1%
Aa2u	8%
P-1	5%
A2	4%
Baa2	5%
NR	28%

Modified duration	Allocation
below 1.00	74%
1.00 to 2.00	20%
2.00 to 3.00	4%
3.00 to 4.00	0%
above 4.00	2%

Paralelisht, tregu i përgjithshëm për bonot e thesarit të Kosovës ka vazhduar të rritet. Duke e pasur rolin e tregtarit primar, Banka dhe klientët e saj vazhduan ta përcaktojnë krijimin e Tregut Sekondar të Borxhit të Qeverisë në Kosovë.

## Instrumentet financiare derivative

Portfolio e kundërkëmbimeve (SWAP) të normave të interesit të Bankës është në mjet i rëndësishëm për uljen e riskut për portfolion e saj afatgjatë. Kundërkëmbimet e normave të interesit përdoren për ta ulur rrezikun nga probabiliteti i lëvizjes së pafavorshme të normave të interesit.

Banka pret që normat e tregut do të lëvizin me lartë në kurbën afatgjate nga normat aktuale historike të ulëta, edhe pse në pjesën e fundit të kurbës së Euros, është shënuar një rënie e mëtejme në kurbë gjatë gjithë vitit. Normat afatgjata për Euro kanë të ngjarë të rriten duke shkuar drejt parashikimeve të mjedisit të përmirësuar ekonomik. Rreziqet politike në Eurozonë vazhdojnë të mbesin dhe navigimi i portofolios së kundërkëmbimeve të normave të interesit (IRS) do të jetë i vështirë. Vlera e pikëve bazë (BPV) e ekspozimit aktual në derivativet financiare është më pak se dhjetë mijë Euro/BPV.

## Biznesi i shkëmbimit të valutës së huaj

Biznesi i këmbimit valutor ka kontribuar me më shumë se 1.637 milionë euro në të ardhurat totale në vitin 2016. Sa i përket të ardhurave nga këmbimi valutor ky është viti më i mirë i dokumentuar. Kjo ka nxitur qarkullimin e Bankës në biznesin e të ardhurave nga komisioni për transferin e fondeve bankës.

Të hyrat në valutë të huaj	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të hyrat nga shkëmbimi valutor në mijë euro	1,766	1,543	1,407	1,283	1,849	1,637

## Biznesi nga ndërmjetësimi

Në vitin 2016, Banka Raiffeisen në Kosovë ka shënuar përvjetorin e pestë në biznesin e ndërmjetësimi. Klientët e Bankës mund të tregojnë në pothuajse të gjitha bursat në botë. Ky funksion u mundëson klientëve të blejnë dhe shesin letra me vlerë të tilla si bonot, obligacionet dhe aksionet në tregjet botërore.

# Segmentet e biznesit

## Korporatat

Në vitin 2016, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të fuqizojë klientët korporata duke ofruar produkte dhe shërbime financiare gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura, duke i mbështetur ato në zgjerimin e kapaciteteve të biznesit dhe duke u mundësuar atyre të arrijnë potencialin e tyre të rritjes. Marrëdhëniet e qëndrueshme të Bankës me klientët kanë vazhduar të mbështesin pozitën udhëheqëse të bankës në segmentin e korporatave në Kosovë.

Korporata ka rritur kapacitetet e saj të kreditimit dhe ka zgjeruar më tutje marrëdhëniet me klientët, të cilat më pas rezultuan në një rritje të portfolios kreditore prej 7.8 përqind në 195,5 milionë euro dhe 18.5 përqind të detyrimeve në 106 milionë euro krahasuar me vitin e kaluar.

Banka gjithashtu ka vazhduar të përqendrohet në përmirësimin e cilësisë së portfolios së korporatave. Kostot e rrezikut janë ulur 17 përqind nga viti i kaluar. Pjesa e kredive jo-performuese (NPL) u ul nga 12.6 përqind në 9.7 përqind ose një rënie prej 22 përqind në krahasim me vitin paraprak.

Segmenti i korporatave ka mbetur një nga kontribuesit kryesorë të profitabilitetit të bankës, pavarësisht zvogëlimit të konsiderueshëm të normave të interesit në tregun e huadhënies.

Përvoja e menaxherëve për marrëdhënie me klientë dhe ekspertiza e menaxherëve të produktit kanë pozicionuar Bankën Raiffesien në Kosovë si bankën kryesore për shumicën e klientëve korporata të vendit, duke treguar besimin në Bankën dhe qëndrueshmërinë e modelit të biznesit të saj.

## Ndërmarrjet e vogla

Segmenti i ndërmarrjeve të vogla (NV) ka mbetur një komponentë e fortë në portfolion dhe segmentin e klientëve të bankës. Prioriteti absolut në shërbimin e ndërmarrjeve të vogla ishte plotësimi i kërkesave dhe nevojave të klientëve duke u ofruar një game të gjerë të produkteve financiare nëpërmjet menaxherëve me përvojë të vendosur në rajonet kryesore të Kosovës të mbështetur me trajnime nga zyra qendrore dhe përmes ekspertizës së menaxherëve të produktit.

NV-të vazhduan t'i përshtaten ndryshimeve të tregut në një mjedis ekonomik të sfidave të vazhdueshme. Gjatë vitit 2016, segmenti i NV-ve u ka shërbyer mbi 1,200 klientëve me një rritje vjetore prej 9 përqind në numrin e klientëve.

Gjatë vitit 2016, qëllimi i segmentit ishte fitimi i klientëve të rinj, si dhe përmirësimi i marrëdhënieve me klientët ekzistues me anë të kreditimit të kujdesshëm, mbështetjes së projekteve fizibile investive dhe ruajtjes së kapitalit punues. Kjo qasje ka rezultuar në të pasurit e një portfolio të kreditimit me një performancë shumë të mirë të rrezikut me një rritje prej 4.5 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Vlen të theksohet se një nga qëllimet e segmentit është mbështetja e rritjes së klientëve dhe transferimi i tyre në segmentin e korporatave. Vëllimi vjetor prej rreth 10 përqind i transformimit në segmentin e korporatave e paraqet këtë.

Duke reflektuar brendin e fortë të bankës dhe besimin e klientëve, në vitin 2016 depozitat e klientëve janë rritur në 25.6 milionë euro, ngritje 8.4 përqind në krahasim me vitin 2015. Portfolio e NV-ve ka treguar një performancë të pranueshme të rrezikut me kosto të ulta të rrezikut dhe një kontribut të konsiderueshëm nga shitja e pasurive të rimarra në posedim.

Me qëllim për të arritur nivelet e synuara të klientëve të NV-ve për miratim të shpejtë të kredisë, janë ndërmarrë disa iniciativa në vitin 2016 që adaptojnë praktikën e menaxhimit 'lean' për të rritur efikasitetin, për të zvogëluar kostot operative dhe në fund për të rritur kënaqësinë e klientit.

Po ashtu, gjatë vitit 2016, Banka ka mbajtur një sërë takimesh me klientët e NV-ve dhe nivelet e larta të menaxhmentit të Bankës së bashku me folësit e ftuar për tema të ndryshme (trendet e tregut dhe të industrisë, tatimi dhe ndryshimet ligjore, zgjidhje financimi dhe produktet investive, normat e interesit) në pesë qytetet kryesore të vendit.

## Ndërmarrjet mikro

Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të ofrojë një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve bankare, standarde dhe të përshtatura për ndërmarrjet mikro.

Gjatë gjithë vitit 2016, Banka ka prezantuar shumë iniciativa për klientët, ku njëra ndër kryesoret ishin takimet e përbashkëta me klientët në të gjitha rajonet e Kosovës. Në keto takime, Banka ka diskutuar dhe shkëmbyer ide me klientët dhe ka shfrytëzuar rastin për të falënderuar klientët për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm me Bankën. Në vitin 2016, Banka gjithashtu ka prezantuar iniciativën 'Projekti më i mirë' në sektorin mikro, i cili ka përzgjedhur projektet më të mira mikro në të gjitha rajonet e Kosovës, duke u bazuar në planin për investim, ndikimin në punësim, rritjen e të ardhurave, prodhimin, idetë inovative, dhe mbrojtjen e mjedisit. Këto nisma janë në përputhje me projektet e mëparshme dhe me strategjinë e përgjithshme të sigurimit të përvojave superiore të klientëve.

Në vitin 2016, Banka ka vazhduar të rrisë pjesën e tregut të biznesit mikro në Kosovë. Ajo ka ofruar produktet dhe shërbimet e saj bankare për më shumë se 15.000 klientë, një rritje prej 7 përqind në krahasim me vitin e kaluar. Banka gjithashtu ka arritur të përmirësojë cilësinë e portfolios së kredisë mikro përmes kreditimit të matur dhe aktiviteteve të ndryshme për mbledhjen e borxhit.

## Individët dhe klientët e shërbimeve bankare premium

Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të jetë lider në treg për biznes individual në Kosovë. Gjatë vitit 2016, Banka ka ofruar produkte dhe shërbime bankare për më shumë se 294,000 individë dhe klientë të shërbimeve bankare premium. Numri i klientëve është rritur me gati 11 përqind në krahasim me vitin e kaluar. Gjatë gjithë vitit, Banka kishte një numër të fushatave të marketingut të fokusuar në kredi, të cilat çuan në një rritje të konsiderueshme të portfolios së kredisë.

Ekipi i shërbimeve bankare premium kanë vazhduar të ofrojnë shërbime të shkëlqyera me qasje proaktive dhe me kryerjen e një qasjeje këshilluese për klientë të veçantë. Gjatë vitit 2016, numri i klientëve të shërbimeve premium është rritur për 5 përqind, përderisa vëllimi i pasurive është rritur me 12 përqind. Përveç produkteve të kreditimit, Banka ua ka ofruar mundësinë për të tregtuar me bonot e thesarit duke bërë që klientët e shërbimeve premium të kenë më shumë mundësi për të maksimizuar kursimet e tyre. Shuma totale e investuar në bono thesare ka arritur në 15 milionë euro. Banka gjithashtu është fokusuar që klientët e shërbimeve bankare premium të kenë mundësinë për të diskutuar në detaje planet e tyre financiare dhe mundësitë e investimeve me këshilltarët e tyre të caktuar financiar të shërbimeve premium në një zonë të veçantë që është caktuar posaçërisht për klientët e shërbimeve bankare premium.

# Produktet dhe shërbimet bankare

## Korporatat dhe ndërmarrjet e vogla

Ngjashëm me vitet e mëparshme, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të fokusohet në krijimin e marrëdhënieve afatgjata dhe të qëndrueshme me klientët, duke mbështetur rritjen e tyre dhe mundësitë e qëndrueshme të biznesit. Kështu, Banka ka vazhduar të lehtësojë dhe përmirësojë produktet dhe proceset e saj në përputhje me nevojat e ndryshueshme të klientëve. Gama e produkteve është përshtatur me nevojat e tregut dhe pritjet e klientëve duke përmirësuar produktet ekzistuese.

Klientët korporata dhe NV vazhdimisht janë duke kaluar në përdorimin e shërbimeve bankare elektronike, që përbën një mënyrë më të përshtatshme, më transparente dhe më pak të kushtueshme. Mbi 73 përqind e të gjitha transaksioneve të klientëve korporata dhe ndërmarrjeve të vogla janë kryer me anë të E-Banking. Gjatë vitit 2016, me anë të një shërbimi të futur rishitazi, i cili përdor SMS për pagesat doganore, janë proceduar mbi 65 përqind të të gjitha pagesave doganore ose 238 milionë euro.

Banka Raiffeisen në Kosovë nga viti në vit vazhdon të dëshmojë pozicionin e saj udhëheqës në treg në aspektin e ofrimit të produkteve. Në vitin 2016, ishte e vetmja bankë në Kosovë që ofronte financim të projekteve dhe faktoring. Sa i përket financimit të projekteve, ajo ka mbështetur zhvillimin e projekteve të pasurive të patundshme me zhvilluesit më të mirë, si dhe zgjerimin e njëres prej qendrave më të mëdha tregtare në Kosovë. Në faktoring, Banka ka ofruar likuiditet dhe fleksibilitet shtesë për klientët, duke mundësuar kërkesa më fleksible të mbulimit të kolateralit.

Ekspertiza e Bankës në financimin e tregtisë, besimi në brend dhe ofrimi i këshillave profesionale kanë vazhduar të mbështesin pozitën udhëheqëse të Bankës në financimin e tregtisë si në dhënie ashtu edhe në pranimin e garancive dhe letrave të kreditit. Gjatë vitit 2016, Banka ka lëshuar 517 produkte në vlerë prej 37 milionë euro që paraqet një rritje për 39 përqind për sa i përket numrit të garancive dhe letrave të kreditit apo 88 përqind në aspektin e vlerës në krahasim me një vit më parë.

## Shërbimet bankare për sektorin retail

Në përputhje me prioritetet e Bankës për rritjen e cilësisë në kanalet elektronike sipas kërkesave të klientëve dhe zhvillimeve të tregut, gjatë vitit 2016 është arritur një rezultat shumë pozitiv. Banka ka arritur të përpunojë 480 mijë transaksione bankare në internet, një rritje prej 26 përqind në krahasim me vitin 2015 dhe ka arritur 42 përqind rritje të numrit të përdoruesve të shërbimeve bankare në internet ose 47 mijë përdorues. Adoptimi i mëtejshëm i aplikacioneve të shërbimeve bankare nëpërmjet telefonit dhe rritja e përdoruesve të telefonave të mençur ka rezultuar në një rritje të suksesshme prej 104 përqind të përdoruesve aktivë të shërbimeve bankare përmes telefonit dhe një rritje prej 70 përqind të pagesave bankare. Përveç kësaj, Banka Raiffeisen në Kosovë ka angazhuar një gamë të gjerë të fushatave dhe festivaleve, që promovojnë transparencën e produkteve dhe shërbimeve elektronike, teknologjinë e përdorur dhe sigurinë e këtyre kanaleve.

Biznesi i kartelave të kreditit dhe debitit ka mbetur një prioritet kryesor gjatë vitit 2016. Banka ka organizuar fushata të ndryshme me partnerë rreth përdorimit të kartelave, të cilat kanë dëshmuar të jenë shumë të suksesshme dhe të pranuar gjerësisht nga klientët. Numri i transaksioneve të procesuara në terminalët e pikave shitjes u rrit me 20 përqind në krahasim me vitin 2015 dhe përdorimi i rrjetit të bankomatëve u rrit me 15 përqind me 4.6 milionë transaksione të procesuara gjatë vitit 2016.


# Menaxhimi i rrezikut

Menaxhimi aktiv i riskut është një kompetencë thelbësore e Bankës Raiffeisen në Kosovë. Në mënyrë që rreziku të identifikohet, matet dhe menaxhohet në mënyrë efektive, Banka vazhdon të zhvillojë sistemin e saj gjithëpërfshirës të menaxhimit të rrezikut. Në mënyrë të veçantë, përveç kërkesave ligjore dhe rregullatore, Banka merr parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të saj të biznesit dhe rreziqet që rezultojnë.

Funksioni i menaxhimit të rrezikut siguron që rreziku kreditor, rreziku i tregut, rreziku i likuiditetit, rreziku i investimeve, si dhe rreziku operacional të identifikohen, maten, monitorohen dhe kontrollohen në mënyrë efektive, në mënyrë që të sigurohet një raport i duhur ndërmjet rrezikut dhe kthimit.

## Strategjia e portfolios kreditorë

Grufiku i mëposhtëm tregon ekspozimin e mbetur të Bankës sipas zonës së biznesit në fund të periudhës raportuese dhe dy periudhat e mëparshme. Gjithsej ekspozimi i rrezikut kreditor ka qenë 922.9 milionë euro më 31 dhjetor 2016 që është për 1.8 përqind më i lartë në krahasim me 31 dhjetor 2015 (906.7 milionë euro) dhe për 10 përqind më i lartë në krahasim me 31 dhjetor 2014 (839.1 milionë euro). Kjo portfolio është diversifikuar ndërmjet segmenteve të klientëve të biznesit dhe klientëve individualë dhe përfshin ekspozimet në dhe jashtë bilancit të gjendjes, para aplikimit të provizioneve të zhvlerësimit (rënies në vlerë) dhe faktorëve të konvertimit të kredive dhe kështu përfaqësojnë ekspozimin e përgjithshëm kreditor.



## Menaxhimi i kredive jo-performuese

2016 ishte një vit shumë i mirë për rimëkëmbjen e kredive jo-performuese dhe Banka pret që i njëjti trend të vazhdojë duke pasur parasysh se përmblyesit privatë vazhdojnë të jenë një nga storiet e suksesshme të sistemit bankar në Kosovë. Raporti i kredive jo-performuese të Bankës ka rënë nga viti në vit në 6.2 përqind.

## Rreziku i likuiditetit

Një rol i rëndësishëm i bankave është transformimi i maturimit në tregjet financiare ndërkombëtare. Nevoja për transformim të maturimit lind nga nevojat e depozituesve për t'u qasur në fondet e tyre në periudhë të shkurtër dhe nevoja e kundërt e huamarrësve për kredi afatgjata. Ky funksion vazhdimisht rezulton në boshllëqe pozitive apo negative të likuiditetit për maturime të ndryshme që menaxhohen përmes transaksioneve me pjesëmarrësit e tjerë të tregut nën kushte normale të tregut.

Për ta menaxhuar rrezikun e likuiditetit, Banka përdor një model limiti të vendosur për një kohë të gjatë tashmë dhe të dëshmuar të grupit RBI, i cili kërkon likuiditet të lartë tepriçë për maturitetet afatshkurtra dhe bazohet në flukset hyrëse dhe dalëse kontraktuale dhe të vëzhguara historikisht. Limitet janë vendosur edhe për maturitetet afatmesme dhe afatgjata, për të pakësuar ndikimin negativ të një rritjeje të mundshme të kostos së rifinancimit mbi rezultatin operativ. Përveç modeleve të limiteve, ndërmerren gjithashtu edhe stres testet e përditshme të likuiditetit për të vlerësuar dhe për të kufizuar efektet e skenarëve të mundshëm të krizave të reputacionit dhe të tregut. Të gjitha këto analiza diskutohen në Komitetin e Aseteve/Detyrimeve të Grupit.

Pozicioni i likuiditetit të Bankës ka vazhduar të mbetet stabil dhe ka zbuluar një rezervë të theksuar të likuiditetit gjatë vitit 2016.

Raporti rregullativ i likuiditetit i Bankës Qendrore të Kosovës

	2016	2015	Kërkesa minimale
Të gjitha valutat	47.2%	51.5%	25.0%
Valuta euro	42.7%	47.7%	20.0%

## Rreziku i tregut

Banka e definon rrezikun e tregut si rreziku i humbjeve të mundshme që rrjedhin nga ndryshimet në çmimet e tregut të pozicioneve të regjistrit (librit) të tregtimit dhe ankës. Ajo nuk ka ekspozim ndaj lëvizjeve të çmimeve të kapitalit dhe mallrave dhe e ka kufizuar ekspozimin e saj ndaj lëvizjeve të normës së interesit dhe kursit valutor.

### Sistemi i limiteve

Vlerat e mëposhtme maten dhe limitohen në baza ditore në sistemin e menaxhimit të rrezikut të tregut:

- Vlera-në-rrezik (niveli i konfidencës 99 përqind, horizonti i rrezikut një ditë)  
Vlera-në-rrezik (VaR) është instrumenti kryesor drejtues në tregjet likuide dhe situatat normale të tregut. VaR matet bazuar në një qasje simulimi hibrid, ku kalkulohe 5,000 skenarë. Qasja kombinon përparësitë e një simulimi historik dhe simulimit Monte-Carlo dhe përfiton parametrat e tregut nga të dhënat historike prej 500 ditësh. Supozimet e shpërndarjes përfshijnë tipare moderne si shpërndarja e paqëndrueshmërisë (volatilitetit), ndryshimi rastësor i kohës, dhe ndodhitë ekstreme. Kjo ndihmon në riprodhimin e shpërndarjeve jonormale (fat-tailed) dhe asimetrike me saktësi. Rezultatet e vlerës në rrezik nuk përdoren vetëm për kufizimin e rrezikut, por edhe për ndarjen e brendshme të kapitalit.
- Ndjeshmëritë (ndaj ndryshimeve në normat e kursit valutor dhe normat e interesit)  
Kufijtë e ndjeshmërisë sigurojnë që përqëndrimet të shmangen në situata normale të tregut dhe janë instrumenti kryesor drejtues në situata ekstreme të tregut dhe në tregjet jolikuide ose në tregje që janë strukturisht vështirë të maten.
- Ndalimi i humbjeve  
Ky limit forcon disiplinën e tregtuesve ashtu që ata nuk lejojnë të grumbullohen humbjet në pozicionet e tyre të pronarit por në vend të kësaj i kufizojnë rreptësisht ato.

Një koncept gjithëpërfshirës i stres testimit e komplementon këtë sistem të limiteve shumë-nivelëshe. Ai simulon ndryshimet e mundshme të vlerës aktuale të skenarëve të përcaktuar për portfolion totale.

## Rreziku operacional

Rreziku operacional përkufizohet si rreziku i humbjeve të papritura, që rezultojnë nga proceset e brendshme jo adekuate ose jo funksionale, nga njerëzit dhe sistemet, ose nga ngjarje të jashtme, duke e përfshirë edhe rrezikun ligjor. Në këtë kategori të rrezikut menaxhohen shtytësit e brendshëm të rrezikut si aktivitetet e paautorizuara, mashtrimi ose vjedhja, gabimet e ekzekutimit dhe procesit, apo ndërprerja e punës dhe dështimet e sistemit. Faktorët e jashtëm si dëmtimi i pasurive fizike apo mashtrimi njerëzor i kryer me vetëdije menaxhohen dhe kontrollohen gjithashtu.



Kjo kategori e rrezikut analizohet dhe menaxhohet në bazë të të dhënave të humbjeve të mëparshme dhe rezultateve të vetë-vlerësimit. Një tjetër mjet i menaxhimit është sistemi i stimulimeve i zbatuar në ndarjen e brendshme të kapitalit. Ky sistem shpërblen cilësinë e lartë të të dhënave dhe menaxhimin aktiv të rrezikut.

Si me llojet e tjera të rrezikut parimi i vendosjes së mureve ndarëse ndërmjet menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të rrezikut është zbatuar edhe për rrezikun operacional. Njësia e kontrollit të rrezikut operacional është kryesisht përgjegjëse për zbatimin dhe përpunimin e metodave për menaxhimin e rrezikut operacional (p.sh. kryerja e vlerësimeve të rrezikut, përcaktimi dhe monitorimi i treguesve kryesorë të rrezikut, etj). Menaxherët e linjës të biznesit janë përgjegjës për kontrollin dhe uljen e rreziqeve operationale. Ata vendosin mbi veprimet pro-aktive drejtuese operationale të rrezikut, të tilla si blerja e sigurimeve, dhe përdorimi i instrumenteve të tjera të uljes së rrezikut.

#### *Identifikimi i rrezikut*

Identifikimi dhe vlerësimi i fushave me rrezik që mund ta rrezikojnë ekzistencën e bankës në qoftë se ndodh humbja (por ku humbjet ka shumë pak gjasa për t'u dalluar) si dhe fushat ku humbjet ka më shumë gjasa të ndodhin shpesh (por shkaktojnë humbje më të vogla) janë detyra të rëndësishme për kontrollin e rreziqeve operationale.

Vlerësimi i rrezikut operacional kryhet në mënyrë të strukturuar sipas kategorive të rrezikut siç janë proceset e biznesit dhe llojet e aktiviteteve. Për më tepër, vlerësimi i rrezikut zbatohet edhe për produkte të reja. Banka e vlerëson ndikimin e aktiviteteve me probabilitet të lartë/ndikim të ulët dhe incidenteve me probabilitet të ulët/ndikim të lartë, sipas vlerësimit të saj të potencialit të humbjes për vitin e ardhshëm dhe në dhjetë vitet e ardhshme. Aktivitetet me probabilitet të ulët/ndikim të lartë maten me një mjet analitik me skenare të veçanta.

#### *Monitorimi*

Për të monitoruar rreziqet operationale, përdoren treguesit kyç të rrezikut (treguesit e paralajmërimit të hershëm), që mundësojnë identifikimin e shpejtë dhe uljen e rreziqeve operationale. Një katalog i përbashkët i treguesve kyç të rrezikut, që është përcaktuar nga Zyra Qendrore e Grupit për qëllime të brendshme krahasimore, është i detyrueshëm edhe për Bankën.

Të dhënat e humbjes mbledhen në një bazë të dhënash të quajtur ORCA (Programi i kontrollit të rrezikut operacional). Mbledhja e humbjeve që rrjedhin nga rreziqet operationale është një parakusht për zbatimin e një modeli statistikor të shpërndarjes së humbjeve dhe një kërkesë minimale për implementimin e qasjes rregullative të standardizuar. Për më tepër, të dhënat për humbjet përdoren për të krijuar dhe për të vërtetuar skenarë të rrezikut operacional dhe për shkëmbimin me grupe të të dhënave ndërkombëtare për të zhvilluar më tej mjete të avancuara të menaxhimit të rrezikut operacional, si dhe për të përcjellë më tej masat dhe efikasitetin e kontrollit. Rezultatet e analizave, si dhe ndodhitë që rezultojnë nga rreziqet operationale raportohen rregullisht në mënyrë gjithëpërfshirëse në Komitetin e Menaxhimit të Riskut Operacional.

#### *Matja dhe ulja e rrezikut*

Banka aktualisht llogarit kërkesat rregullative të kapitalit për rreziqet operationale sipas Basel III duke përdorur qasjen e standardizuar (TSA). Ulja e rrezikut operacional inicohet nga menaxherët e biznesit të cilët vendosin për veprimet parandaluese si dhe uljen e rrezikut ose transferimin e rrezikut. Progresi dhe suksesi i këtyre veprimeve monitorohet nga kontrolli i rrezikut. Këta të fundit përcaktojnë edhe planet rezervë dhe emërojnë personat apo departamentet përgjegjëse për fillimin e veprimeve të përcaktuara në qoftë se humbjet në fakt ndodhin. Përveç kësaj, një njësi e dedikuar organizative ofron përkrahje për njësitë e biznesit për uljen e rreziqeve operationale. Një rol të rëndësishëm e merr menaxhimi i mashtrimit që zvogëlon humbjet e mundshme të mashtrimit përmes monitorimit proaktiv dhe veprimeve parandaluese. Banka gjithashtu zbaton një program të gjerë të trajnimit të punonjësve dhe ka vendosur plane të ndryshme për emergjencë dhe sisteme rezervë.

## Ndryshimet në mjedisin rregullativ

Banka ka ndjekur nga afër zhvillimet aktuale rregullative dhe ato të vitit 2017. Sektori bankar i Kosovës mbetet shumë dinamik me ndryshimet në legjisllacion në përputhje me BE-në.

Fokusi, gjatë vitit 2016, ishte mbi ndryshimet në Rregulloren për praktikat e mjaftueshmërisë së kapitalit. Në vitin 2017 do të hyjë në fuqi Rregullorja mbi menaxhimin e rrezikut të normës së interesit në librin bankar dhe Banka është plotësisht e përgatitur për t'i respektuar këto rregullore të reja.

Në vitin 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka lëshuar një letër këshilluese në lidhje me Procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit (ICAAP), për të cilën Banka beson se do të pasohet nga rregullore të reja. Si pjesë e grupit Raiffeisen Bank International (RBI), Banka i nënshtrohet edhe ndryshimeve në mjedisin rregullativ të BE-së. Kjo na mundëson që t'i përshtatemi paraprakisht ndryshimeve në rregulloret lokale të cilat synojnë të harmonizohen me rregulloret e BE-së.

# Kanalet e distribuimit

Raiffeisen Bank në Kosovë ka një rrjet të gjerë të degëve në 50 lokacione në të gjithë vendin, duke ofruar shërbime për të gjithë qytetarët. Nëpërmjet degëve dhe nëndegëve të saj rajonale, Raiffeisen Bank në Kosovë ofron një gamë shumë të larmishme të shërbimeve dhe produkteve financiare, shërbime këshillimore profesionale, produkte të kualitetit të lartë dhe një angazhim të thellë për ekonominë dhe shoqërinë vendore.

Gjatë vitit 2016, Banka ka vazhduar të investojë në rrjetin ekzistues të degëve të saj nëpërmjet rimodelimit të katër degëve dhe krijimin e zonave të vetëshërbimit, gjë që do t'i mundësojë klientëve t'i përdorin lehtësisht kanalet alternative, të tilla si E-Banking, makinat e parave të gatshme, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Aktualisht, 93 përqind e transaksioneve kryhen në bankomatë, ndërsa vetëm 7 përqind kryhen në degët. Kanalet e distribuimit të Bankës Raiffeisen në Kosovë gjithashtu u mundësojnë klientëve të kenë qasje të thjeshtë dhe të lehtë në produktet bankare përmes agjentëve të shitjes direkte dhe Qendrës kontaktuese.

## Agjentët e shitjes direkte

Ky rrjet operon me 62 agjentë bankar që veprojnë si bankierë mobilë, me qëllim që të jenë afër klientëve sa herë që ata duan të kenë takim për këshilla profesionale në lidhje me produktet dhe shërbimet bankare. Ata plotësojnë rrjetin e degëve të bankës duke u shërbyer klientëve kudo që ata ndodhen.

## Qendra kontaktuese

Qendra kontaktuese shërben si një kanal alternativ për shërbime 24/7 për klientët, duke ua lehtësuar kështu si klientëve ekzistues edhe atyre potencialë komunikimin në baza ditore me Bankën. Qendra kontaktuese e Bankës Raiffeisen në Kosovë ka katër aktivitete kryesore: trajtimin e kërkesave të klientëve përmes telefonatave, telemarketing, fushata informuese dhe pyetësorë të ndryshëm. Qendra kontaktuese shërben si një qendër e rëndësishme mbështetëse, e cila trajton një shumëllojshmëri të pyetjeve të klientëve dhe e cila ofron konsultime për klientët në lidhje me produktet bankare nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit - telefon, e-mail, chat, këndit informativ dhe qendrës së komunikimit përmes E-Banking. Për t'u përgjigjur shpejt klientëve, Qendra kontaktuese ofron një shërbim falas për pranimin e ankesave të klientëve.

## Rrjeti i pikave të shitjes

Ky shërbim ua ofron mbajtësve të kartelave mundësinë që t'i përdorin kartelat e tyre të debitit dhe kreditit të llojeve Visa, Visa Electron, MasterCard dhe Maestro në pikat e shitjes (POS), me mundësinë që të blejnë me këste gjërat me vlerë më të lartë. Rrjeti POS është i shtrirë në të gjithë vendin dhe ofron këtë shërbim për më shumë se 60 kategori të ndryshme tregtare, duke përfshirë hotelet, agjencitë e udhëtimit, dyqanet, restorantet, pompat e benzinës, supermarketet dhe qendrat më të mëdha tregtare në vend. Në vitin 2016, Banka Raiffeisen e zhvilloi më tej rrjetin e saj POS në të gjithë vendin dhe arriti në 1.817 pika, duke rezultuar në një rritje të numrit të transaksioneve për 22 përqind.

## Përvoja e klientit

Banka Raiffeisen në Kosovë ka investuar në formësimin e përvojës së klientit në mënyrë që klienti të jetë në qendër të proceseve dhe të gëzojë një përvojë të paharrueshme dhe pozitive. Mendimi i klientëve luan një rol shumë të rëndësishëm në identifikimin e pritjeve të klientëve ndaj produkteve dhe shërbimeve të Bankës. Matja e nivelit të kënaqshmërisë së klientëve i mundëson Bankës që në mënyrë të vazhdueshme ta përmirësojë cilësinë e shërbimeve. Investimet që i ka bërë Banka për krijimin e një procesi të duhur dhe të përshtatshëm të menaxhimit të ankesave ka rezultuar me rezultate më të larta të shpejtësisë së zgjidhjes së ankesave dhe ka rënë në një mesatare prej 3,7 ditë në vitin 2016, nga 4,6 ditë sa ishte gjatë vitit 2015.

# Burimet njerëzore dhe trajnimet

Të qenit punëdhënës i zgjedhur në Kosovë është misioni i Bankës Raiffeisen, që demonstroi një angazhim të madh drejt punonjësve të saj.

Departamenti i burimeve njerëzore dhe trajnimit në Bankë është përgjegjës për të siguruar që njerëzit e duhur janë në pozitat përkatëse dhe se kapacitetet e tyre pasurohen me anë të aktiviteteve të zhvillimit. Arritja e objektivave të korporatës përmes punonjësve profesionalë, shumë të motivuar, të angazhuar dhe të kënaqur, është misioni i Departamentit të burimeve njerëzore dhe të trajnimit.

Më 31 dhjetor 2016, Banka ka pasur 808 punonjës (661 me orar të plotë, 127 me orar të pjesshëm), si dhe 66 agjentë të shitjes direkte. Krahasuar me vitin 2015, numri i përgjithshëm i punonjësve në vitin 2016 ka pasur një rritje prej 0,5 përqind. Numri i punonjësve të rinj që janë bërë pjesë e Bankës ishte 42. Gjatë vitit 2016 janë organizuar dy programe të praktikës. Numri i praktikantëve të cilët ishin pjesë e programeve të praktikës ishte 103. Qëllimi i një programi të praktikës është për t'i mbështetur studentet që nuk kanë diplomuar ende, studentët në studimet master dhe kandidatët e diplomuar.

Mosha mesatare e punonjësve ishte 36 vjeç, duke treguar një kapital njerëzor relativisht të ri. 50.9 përqind e punonjësve ishin gra, ndërsa 49.1 përqind të numrit të përgjithshëm të punonjësve ishin burra.


## Menaxhimi i talentit

Gjatë vitit 2016 ka vazhduar fokusi në rritjen e ndërgjegjësimit dhe aftësive të menaxherëve të Bankës në drejtim të aftësive njerëzore. Aktivitetet e menaxhimit të talentit janë organizuar në të gjithë Bankën përmes një procesi që është i lidhur shumë ngushtë me ngritjen e brendshme në detyrë dhe zhvillimin e fokusuar. Banka ka vazhduar t'i realizojë iniciativat zhvillimore, qendrën e vlerësimit të zhvillimit, programet e rotacionit dhe ndër-funksionale, si dhe detyrat e përshtatura mësimore. Këto programe brenda Bankës si dhe programet ndërkombëtare të zhvillimit synojnë ta thellojnë më tutje ekspertizën e punonjësve dhe menaxherëve më të talentuar të Bankës përmes një kombinimi inovativ të metodave praktike, alternative dhe akademike të të mësuarit. Ekzistojnë edhe disa tregues kryesor të performancës të përcaktuar nga disa udhëheqës për ta rritur fokusin në këtë fushë të menaxhimit të burimeve njerëzore.

## Zhvillimi profesional

Banka është e angazhuar për të siguruar se punonjësit e saj të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre duke u ofruar atyre një shumëllojshmëri të mundësive të të mësuarit dhe zhvillimit përmes trajnimit në vend të punës, trajnimit të brendshëm dhe të jashtëm në klasë, E-Learning (të mësuarit elektronik), detyrave dhe përfshirjes në projekte sfiduese vendore dhe ndërkombëtare. Këto projekte kanë rezultuar në përmirësimin e njohurive në fushën e produkteve dhe shërbimeve bankare. Në këtë mënyrë, Banka ka fituar një përparësi konkurruese në treg duke ofruar një shërbim më profesional dhe më efikas për klientët e saj. Një fokus i veçantë i është dhënë konceptit të vetëzhvillimit dhe iniciativës vetanake për planifikimin e karrierës me takime të përshtatura gjysmëditore.

Gjatë vitit 2016, 80 përqind e punonjësve kanë marrë pjesë në programe të ndryshme trajnimi dhe pothuajse 100 përqind kanë marrë pjesë në seminare. Shifrat tregojnë një nivel të shkëlqyer të arritjeve të standardeve evropiane, me gati 3.2 ditë të trajnimit për punonjës në vitin 2016. Gjatë vitit 2016, numri i ditëve të trajnimit ka qenë 2,805 ditë. Duke zgjeruar gamën e ofertave të trajnimit, duke ruajtur numrin e trajnerëve të brendshëm, dhe duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e ofrimit të trajnimit, Banka arriti të organizojë një numër të madh të kurseve për punonjësit e saj.



Banka bashkëpunon me ofrues të ndryshëm të trajnimit brenda dhe jashtë Kosovës për programe specifike trajnimi. Identifikimi i nevojave të trajnimit bëhet vazhdimisht për të pasur programe të përshtatura që i plotësojnë nevojat e punonjësve. Ekzistojnë gjithashtu plane individuale të zhvillimit të përkrahura me trajnime individuale për një numër të punonjësve, të cilat fokusohen në mënyrë specifike mbi aftësitë e një individi dhe risin mundësinë e zhvillimit personal.


E-Learning është bërë tashmë një platformë të mësuarit shumë mirë e pranuar e nga shumica e punonjësve. Në vitin e saj të gjashtë të ekzistencës, ka pasur një nivel mbresëlënës të interesimit dhe përkrahjes nga ana e punonjësve të Bankës për të hartuar dhe ndjekur kurse të krijuara brenda organizatës. Gjatë vitit 2016, ka pasur pothuajse 4.000 regjistrime të personelit në kurset on-line të zhvilluara dhe planifikuara nga vetë Banka dhe kurset e Raiffeisen Bank International (RBI). Përmes E-Learning dhe mësimit të përzier, Banka tashmë është bërë më efikase dhe më ekonomike në ofrimin e programeve për të gjithë punonjësit në një periudhë shumë të shkurtër kohore. Seminarët në internet dhe testimi online i njohurive ishin metodat tjera të reja të përdorura përmes platformës online në vitin 2016.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, Banka ka vazhduar t'i përkrahë punonjësit për kurse specifike profesionale dhe të licencimit në një gamë temash që nga trajnimi për aftësi teknike e deri te aftësitë sociale, si pjesë e ngritjes së kapaciteteve. Mësimi gjatë gjithë jetës mbetet një nga mesazhet kryesore në Bankë. Përveç të gjithë mësimit të zhvilluar, kishte gjithashtu një fokus të vazhdueshëm në organizimin e ngjarjeve argëtuese për ta arritur ekuilibrin punë-jetë dhe për ta zhvilluar socializimin në mesin e punonjësve.

# Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia shoqërore e korporatës

Qëndrueshmëria ka qenë gjithmonë një parim themelor për Grupin RZB dhe një masë e suksesit të korporatës. Për 130 vjet, Raiffeisen ka kombinuar suksesin financiar me veprimet me përgjegjësi sociale. Banka e kupton qëndrueshmërinë si aktivitetet e përgjegjshme të korporatës për sukses afatgjatë ekonomik duke marrë në konsideratë aspektet kyçe shoqërore dhe mjedisore.

Si një vartëse e Raiffeisen Bank International (RBI), Raiffeisen Bank në Kosovë është e përkushtuar që të punojë në përputhje me parimet "Global Compact" të OKB-së<sup>1</sup>.



Për këtë arsye, Banka angazhohet për harmonizimin e strukturave të saj të menaxhimit dhe proceseve me këtë qëndrim. Në tri zonat e qëndrueshmërisë, "bankier i përgjegjshëm", "partner i drejtë" dhe "qytetar i angazhuar", të cilat janë të lidhura ngushtë me aktivitetet e biznesit, Banka bën përpjekje për t'i zbatuar në mënyrë optimale vlerat dhe aftësitë e saj për ta inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm në kompani dhe në shoqëri.

Duke u udhëhequr nga parimet e saj udhëzuese të qëndrueshmërisë, Banka punon që ta bëjë biznesin të qëndrueshëm, dhe dëshiron të krijojë vlerë të qëndrueshme për palët e saj të interesit. Aktivitetet afariste operationale janë të lidhura me ndikimet mjedisore që Banka përpqet t'i mbajë sa më të vogla që është e mundur përmes menaxhimit sistematik mjedisor. Si punëdhënëse, Banka është përgjegjëse për të siguruar kushte të sigurta dhe tërheqëse të punës për punonjësit e saj. Si anëtare e shoqërisë, Banka dëshiron të kontribuojë për të mirën e përbashkët edhe përtej aktiviteteve afariste dhe të ndërmarrë veprime në përputhje me aftësitë e Bankës.

<sup>1</sup> Një thirrje për kompanitë për t'i harmonizuar strategjitë dhe operacionet me parimet universale të tre drejtave të njeriut, të punës, mjedisit dhe anti-korrupsionit, dhe për të ndërmarrë veprime të cilat avancojnë qëllimet e shoqërisë. [www.unglobalcompact.org](http://www.unglobalcompact.org)

Si një grup bankar aktiv në nivelin ndërkombëtar, Banka përballlet me sfida specifike në përpjekjet e saj për ta realizuar vizionin e saj të qëndrueshmërisë. Këto sfida dalin nga ndikimet ekonomike, sociale dhe mjedisore të aktiviteteve të saj të biznesit, si dhe nga kushtet e jashtme brenda të cilave operon Banka. Ajo punon në një mjedis global që karakterizohet nga rreziqe të shumta ekonomike, gjeopolitike dhe mjedisore. Vetë sektori i shërbimeve financiare është ballafaquar me shumë sfida dhe rreziqe, veçanërisht në vitet e fundit. Për të mbetur profitabil në aspektin afatgjatë, këto sfida kërkojnë një kulturë të fortë të menaxhimit të rrezikut dhe të qëndrueshmërisë. Krahas rreziqeve klasike bankare, stabilitetit të sistemit financiar dhe rreziqet e reputacionit, temat e tilla si, korrupsioni, pastrimi i parave dhe sektorët me rrezik të lartë, gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm. Kjo përfshin, për shembull, fushat CO<sub>2</sub> - intensive, të tilla si, nafta, gaz i lartë dhe energjia (p.sh. gaz i argjilior), energjia bërthamore, industria e armëve (p.sh. armët dhe municionet thërrmuese), prodhimi bujqësor i lëndëve të para dhe ushqimi (p.sh. vaj i palmës, spekulimet mbi çmimet e ushqimit, monokultura).

Ballafaqimi në mënyrë të duhur me rreziqet është pjesë e modelit të biznesit të Bankës. Si një grup bankar, ajo i përmbahet standardeve përkatëse të qëndrueshmërisë mes të gjitha këtyre rrethanave, ashtu siç presin palët e saj të interesit:

- Si një Bankë, ajo është e përkushtuar ndaj standardeve ligjore dhe etike, si dhe duhet të sigurojë që këto standarde përmbushen.
- Si pasojë e krizës financiare që ndodhi disa vite më parë, industria e shërbimeve financiare pësoi një humbje të besimit. Që atëherë, bankat kanë qenë nën vëzhgim të afërt nga palët e tyre të interesit dhe e gjejnë veten subjekt ndaj kërkesave më të rrepta rregullatore. Prandaj, Banka punon për ta bërë biznesin e saj të qëndrueshëm dhe dëshiron të krijojë vlera të qëndrueshme për palët e saj të interesit.
- Aktivitetet operative të biznesit të Bankës janë të lidhura me ndikimet mjedisore të cilat Banka përpiqet t'i mbajë sa më të vogla të jetë e mundur përmes menaxhimit sistematik të mjedisit.
- Si një punëdhënëse, Banka është përgjegjëse për të siguruar kushte të sigurta dhe tërheqëse të punës për punonjësit e saj.
- Si anëtare e shoqërisë, Banka dëshiron të kontribuojë për të mirën e përbashkët edhe përtej aktiviteteve afariste dhe të ndërmarrë veprime në përputhje me aftësitë e saj.

## Bankieri i përgjegjshëm

### *Qeverisja dhe pajtueshmëria*

Raiffeisen Bank në Kosovë Sh. A. i përshkruan vlerë të madhe menaxhimit të përgjegjshëm dhe transparent të biznesit për të forcuar dhe për të ruajtur mirëkuptimin dhe besimin e palëve të saj të interesit. Ky është një parakusht për mbarëvajtjen e grupit bankar. Vlerat tradicionale të bankës Raiffeisen sigurojnë bazën për këtë si edhe Kodi i Sjelljes i cili zbatohet në tërë grupin.

### *Politika e kreditimit dhe politika e vendimit të kreditimit*

Modeli i biznesit i Bankës është i orientuar rreth qëllimit strategjik të nivelit të lartë të krijimit të vlerës afatgjate. Kredithënia e përgjegjshme është një komponent i rëndësishëm i këtij modeli. Banka e arrin këtë me një politikë të kreditimit që është e bazuar në mbajtjen e vazhdimësisë. Banka mbetet një huadhënëse i drejtë dhe i besueshëm për bizneset me perspektiva për të ardhmen, madje edhe në kohë të vështira, si dhe mban një pozicion të qartë në lidhje me trajtimin e fushave të ndjeshme të biznesit. Raiffeisen Bank në Kosovë ka prezantuar një sistem të menaxhimit mjedisor dhe social, duke përfshirë edhe politikën përkatëse. Qëllimi i kësaj politike është për të kryer biznesin si një qytetar korporativ, i mirë dhe i përgjegjshëm. Prandaj, Banka përpiqet t'i respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret e Kosovës, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me çështjet mjedisore dhe shoqërore dhe është e përkushtuar që ta përmirësojë kapacitetin e menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe shoqëror (M&S) për t'i zvogëluar rreziqet e kredisë dhe detyrimeve.

## Kredidhënia e përgjegjshme

Banka është e përkushtuar për politikat e përgjegjshme të kredidhënies. Kjo do të thotë që Banka përpiqet të japë kredi për klientët vetëm atëherë sa mund ta përballojë gjendja e tyre financiare. Nëse klientët megjithatë hasin në vështirësi financiare, Banka i përkrah ata sa më mirë që mundet me informacion dhe këshilla.

### *Kënaqshmëria e klientëve*

Kënaqshmëria e klientëve është prioriteti kryesor i Bankës. Prandaj, kjo matet rregullisht në kuadër të Grupit RBI, si në biznesin retail ashtu edhe të korporatave, për të mundësuar veprimin e duhur sipas nevojës. Kënaqshmëria e klientëve dhe cilësia e shërbimit në biznesin retail janë matur për disa vite. Net Promotor Score (NPS) është përdorur si tregues kyç për kënaqësinë.

### *Praktikat e përgjegjshme të shitjes dhe marketingut*

Çështjet financiare janë çështje besimi. Prandaj, Banka Raiffeisen në Kosovë përpiqet për etiketimin të qartë dhe transparent të produkteve dhe shërbimeve për të gjithë klientët dhe palët e interesit. Me rastin e reklamimit dhe marketingut të produkteve bankare, Banka i përmbahet parimeve të rrepta të destinuara për të mbrojtur klientët e saj. Banka mendon që reklamimi i rrejshëm apo çorientues është diçka e papranueshme.

## Partner i drejtë

### *Korrupsioni dhe pastrimi i parave*

Banka ndërmerr të gjitha veprimet për të shmangur çdo formë të korrupsionit, pastrimit të parave, mashtrimit apo tregtimit insider (përdorim i informacionit të privilegjuar me qëllim përfitimin). Një parakusht në praktikat e saj biznesore dhe operacionale është sjellja e drejtë, etike dhe në përputhje me ligjin e të gjithë anëtarëve të personelit. Mekanizmi që e siguron respektimin është kodi i sjelljes (CoC) dhe rregulloret e qarta, të detajuara të përfshira në Manualin e Përputhshmërisë.

### *Burimet njerëzore*

Vetë-përgjegjësi është pjesë e rëndësishme e kulturës korporative. Menaxhmenti ekzekutiv demonstron sjellje të përgjegjshme dhe të qëndrueshme biznesore. Banka nuk i vlerëson menaxherët dhe punonjësit vetëm sipas rezultateve të tyre, por edhe sipas sjelljes së tyre.

### *Shëndeti dhe siguria*

Punonjësit e shëndetshëm dhe në krye të detyrës përbëjnë bazën për sukses të çdo kompanie. Përveç masave të përcaktuara me ligj, Banka ofron aktivitete të shumta vullnetare të tilla si kontrollet shëndetësore, trajnim për menaxhimin e stresit. Banka e konsideron obligim caktimin e njerëzve në përputhje me shkathtësitë dhe aftësitë e tyre dhe zhvillimin e performancës së tyre. Standardet ligjore për shëndetin dhe sigurinë në punë respektohen në Bankë.

### *Ekologjia e brendshme*

Ekologjia e brendshme e Bankës ka të bëjë me optimizimin e përdorimit të energjisë dhe burimeve, dhe si e tillë përbën obligim për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve dhe pajtueshmërinë me standardet e saja të larta.

### *Qytetar i angazhuar*

Banka e konsideron veten të jetë një qytetar korporativ i angazhuar e cila në mënyrë aktive promovon zhvillimin e qëndrueshëm në shoqërinë e saj. Angazhimi si qytetar korporativ shkon përtej biznesit bazë dhe ka për qëllim t'i kundërvihet problemeve shëndetësore dhe sociale; promovimin e jetës kulturore, edukimin dhe sportin.

## Projektet dhe iniciativat e mbështetura

Gjatë vitit 2016, Raiffeisen Bank në Kosovë ka vazhduar të jetë sponsor tradicional i projekteve të ndryshme dhe ka mbështetur iniciativat e reja në pesë fusha kryesore: në shëndetësi, kulturë, arsim, sport, dhe mirëqenie sociale.

Banka ka mbështetur sektorin e shëndetësisë duke iu dhuruar pajisje gjashtë spitaleve rajonale të Kosovës, në vlerë prej 50,000 eurove. Ndërsa, ka vazhduar të mbështesë projekte kulturore dhe të jetë partner tradicional në Galerinë Kombëtare - Ekspozita Muslim Mulliqi, Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Prishtinë, Festivali i Pianos Chopin, Teatrin Profesionist në Ferizaj, Qendra për Art Bashkëkohor në Prishtinë - Artistët e së nesërmes.

Në fushën e arsimit, për pesë vite me radhë, Banka ka mbështetur "ATOMI", një projekt i cili ka për qëllim identifikimin e nxënësve të talentuar me inteligjencë të lartë dhe të ofrojnë mundësi, kushte, trajtim, kujdes dhe arsimim të veçantë për këta nxënës. Gjatë vitit 2016, u organizua "Festivali Digjital". Festivali Digjital është një festival i organizuar me qëllim të promovimit dhe edukimit për trendet digjitale. Festivali mbështet një program të gjerë dhe të larmishëm të evenimenteve, punëtorive, konferencave, kurseve të trajnimit, paneleve, diskutimeve, sesioneve informuese dhe hakatonët që janë zhvilluar nga Qendra e Inovacionit të Kosovës dhe e mbështetur nga Banka Raiffeisen në Kosovë.

Sa i përket sportit, Banka ka mbështetur projektin Programin për zhvillimin e rinisë në Federatën e Basketbollit të Kosovës. Projekti përfshin organizimin e kampeve nacionale verore të basketbollit dhe pjesëmarrjen e lojtarëve të Kosovës nën 14 vjeç në kampe ndërkombëtare, vizita observuese për trajnerët në Turqi dhe organizimin e një turneu në Kosovë për lojtarët nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në projekt. Gjatë gjithë sponsorizimit të Programit për zhvillimin e rinisë, Banka mbështeti të gjitha ekipet kombëtare të të rinjve (nën 20, 18, 16 vjeç si për djemtë ashtu edhe për vajzat) që garuan në gara të ndryshme që organizohen çdo vit nga FIBA Europe.

Viti 2016 ishte viti i dytë që Banka mbështeti "Konkursin e ideve të Biznesit - të gjelbërta dhe inovative", të organizuar nga Forumi për Iniciativa Qytetare. Qëllimi i këtij projekti është që të identifikojë idetë kreative, inovative biznesore dhe me përgjegjësi shoqërore nga ndërmarrësit e rinj në Kosovë, të cilat paraqesin një qasje më sociale për sipërmarrësinë, se sa të koncentrohen në fitime dhe kapital për përfitime personale.

Gjatë vitit 2016, bamirësia H. Stepic CEE Charity<sup>2</sup>, ka vazhduar të mbështesë "Bërja e ndryshimeve për fëmijët në Fushë Kosovë", nga organizata Partneriteti i Ideve (TIP), e cila fokusohet në aktivitete në kopshtin e fëmijëve dhe aktivitete të tjera arsimore. Ky projekt është financuar nga Banka dhe Bamirësia H. Stepic CEE Charity, me seli në Vjenë. Ky projekt ka ofruar mundësi të reja për edukimin e fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian (RAE) në Kosovë.

Si pjesë e aktiviteteve vullnetare nga ana e të punësuarve në Bankë, u mblodhën më shumë se 100 dhurata për fëmijët në nevojë në fund të vitit për aktivitetin e "Surpriza në kuti". Përveç kësaj, rreth 100 punonjës të Bankës kanë marrë pjesë në dhurimin e gjakut që u zhvillua në Prishtinë.

### *Edukimi financiar/njohuritë financiare dhe çështje tjera arsimore*

Edukimi në sektorin financiar është një nga çështjet më të rëndësishme të shekullit 21. Banka në mënyrë aktive promovon të kuptuarit e produkteve dhe shërbimeve financiare dhe përfshin ekspertizën bankare si pjesë e rolit këshillues të Bankës në operacionet e përditshme. Aktivitetet e Bankës janë të lidhura ngushtë me temën e edukimit financiar, d.m.th trajtimin kompetent të parave dhe çështjeve financiare, gjithashtu të përmendura nën termin "njohuritë financiare (financiar literacy)".

<sup>2</sup> Bamirësia H. Stepic CEE Charity u themelua në vitin 2006 nga Herbert Stepic, ish Drejtor ekzekutiv i bankës Raiffeisen Bank International, kjo bamirësi promovon dhe përkrah njerëzit në nevojë - veçanërisht gratë dhe fëmijët - në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL) në lidhje me çështjet sociale, ekonomike dhe çështjet e shëndetit. <http://www.stepicceecharity.org>



*Iniciativat tjera*

Përfaqësuesit e Departamentit të Burimeve njerëzore dhe trajnimit të Bankës morën pjesë në një panair të karrierës me qëllim që të jenë më afër punëkërkuësve të Kosovës. Për më tepër, u mbajt një prezantim publik me temën "Punësimi dhe mundësitë e praktikës profesionale" në Bankën Raiffeisen në Kosovë të organizuar nga Qendra për zhvillim të karrierës në Universitetin e Prishtinës. Në këto ngjarje interaktive, qëllimi kryesor ishte për t'i informuar të diplomuarit dhe studentët në lidhje me mundësitë e punësimit në Bankën, dhe ngritjen e vetëdijes tek studentët për vetëinvestime dhe vetëzhvillim për të qenë konkurrues në tregun aktual të vështirë.

Gjatë vitit 2016, Banka ka organizuar një vizitë në Bankë për Down Syndrome Kosova. Gjatë këtij aktiviteti, fëmijët me Sindrom Down kanë shitur kartolinat e punuara me dorë dhe kanë marrë pjesë në aktivitetet e pikturimit ku pikturat janë shpërndarë nëpër mjediset e Bankës. Objektivi kryesor i këtij aktiviteti ishte rritja e ndërgjegjësimit për fëmijët me Sindrom Down dhe mbështetjen e integritit të tyre në shoqëri.

---

# Pasqyrat financiare

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat individuale financiare për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2016 janë të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)

Shënimet për pasqyrat financiare individuale janë përkthim i versionit origjinal në anglisht. Në rast të mospërputhjes do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

---

<b>Deklarata mbi përgjegjësinë e menaxhmentit</b>	<b>36</b>
Raporti i auditorit të pavarur	37
Pasqyra individuale e pozicionit financiar	38
Pasqyra individuale e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	39
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	40
Pasqyra individuale e rrjedhës së parasë	41
Shënime mbi pasqyrat financiare individuale	42-79

# Deklarata mbi përgjegjësinë e menaxhmentit

## Për aksionarët dhe Bordin Mbikëqyrës të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a.


Ne kemi përgatitur pasqyrat financiare si më datën 31 dhjetor 2016 dhe për vitin e mbyllur në atë datë, të cilat paraqesin në mënyrë të saktë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a. (në tekstin e mëtejshëm "Banka") si më 31 dhjetor 2016 si dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur. Menaxhmenti është përgjegjës për të siguruar se Banka i mbanë llogaritë në pajtueshmëri me rregulloret bankare të Kosovës dhe të cilat mund të ndryshohen në mënyrë të përshtatshme për të shpalosur me saktësi të arsyeshme pozitën financiare të Bankës dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar që përfshijnë edhe Standardet dhe Interpretimet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të cilat janë nxjerrë nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB) dhe Komiteti Ndërkombëtar për Interpretime të Raportimit Financiar (IFRIC) i IASB-së, të cilat janë relevante për veprimtarinë e saj dhe të cilat ishin në fuqi për periudhën të cilën e mbulojnë të dhënat. Menaxhmenti ka edhe përgjegjësi të përgjithshme për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm në dispozicionin e vet për të ruajtur asetet e Bankës dhe për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimet dhe parregullsitë tjera.

Menaxhmenti konsideron se, gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, Banka i ka shfrytëzuar politikat adekuate kontabël, të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente dhe janë mbështetur nga gjykime dhe vlerësime të arsyeshme dhe të matura, dhe se gjatë kësaj janë respektuar Standardet përkatëse Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Rrjedhimisht, pasqyrat financiare konsiderohen të miratuara nga Bordi Menaxhues.

Prishtinë, Kosovë  
21 mars 2017


Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë



**Robert Wright**  
Kryesues i Bordit Menaxhues



**Shukri Mustafa**  
Anëtar i Bordit Menaxhues



**Iliriana Toçi**  
Anëtare e Bordit Menaxhues



**Johannes Riepl**  
Anëtar i Bordit Menaxhues

# Raporti i auditorit të pavarur

Për Aksionaret e Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

## Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera sqaruese. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2016, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Çështjet tjera

Pasqyrat financiare individuale të Bankës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015 janë audituar nga auditor tjetër që lëshoi opinion të kualifikuar më datë 1 prill 2016.

## Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës të Kontabilistëve të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodit IESBA) së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare individuale

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## Përgjegjësitë e auditorit

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijin si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticism të profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare individuale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga menaxhmenti.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e menaxhmentit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Banka të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë. Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., midis të tjerash, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme të kontrollit të brendshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.


## Pasqyra individuale e pozicionit financiar

(shumat në € '000)	Shënimet	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Pasuritë</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme	6	121,471	100,916
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	7	40,564	40,442
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	8	495,691	450,596
Investimet në letra me vlerë	9	207,749	229,204
Pasuri tjera	10	1,436	1,732
Investimet në vartës	11	2,234	336
Pronat, pajisjet dhe pasuritë e paprekshme	12	10,399	8,202
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>879,544</b>	<b>831,428</b>
<b>Detyrimet</b>			
Depozitat nga klientët	13	724,969	675,199
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	14	511	2,202
Provizionet dhe detyrimet tjera	15	8,368	4,737
Këmbimi i normës së interesit i pagueshëm	15	1,639	1,560
Detyrimi i tatimit aktual		315	825
Detyrimi i tatimit të shtyrë	23	1,584	2,249
Kredi e varur	16	19,336	19,336
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>756,722</b>	<b>706,108</b>
<b>Kapitali i aksionarëve</b>			
Kapitali aksionar		63,000	63,000
Rezerva e vlerës së drejtë		(40)	(50)
Fitimet e mbajtura		59,862	62,370
<b>Gjithsej kapitali i aksionarëve</b>	17	<b>122,822</b>	<b>125,320</b>
<b>Gjithsej detyrimet dhe kapitali i aksionarëve</b>		<b>879,544</b>	<b>831,428</b>

E aprovuar që të lëshohet në emër të menaxhmentit të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a. dhe e nënshkruar në emër të tyre më 21 mars 2017.



**Fatos Shllaku**  
Drejtor i financave



**Robert Wright**  
Drejtor ekzekutiv

Pasqyra individuale e gjendjes financiare lexohet së bashku me shënimet që përbëjnë pjesë të pasqyrave individuale financiare të paraqitura në faqet 42 deri 79.

## Pasqyra individuale e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

(shumat në € '000)	Shënimet	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Të ardhurat nga interesi	18	39,438	42,138
Shpenzimet nga interesi	18	(3,000)	(3,824)
<b>Neto të ardhurat nga interesi</b>		<b>36,438</b>	<b>38,314</b>
Humbjet nga rënia në vlerë në kreditë dhe paradhëniet për klientët	8	(4,893)	(3,084)
Humbjet nga rënia në vlerë në kreditë dhe paradhëniet për bankat		13	-
Kthimi nga kreditë e shlyera paraprakisht		1,484	1,443
Provizioni për humbjet nga zotimet dhe detyrimet kontingjente		(8)	39
<b>Neto të ardhurat nga interesi pas provizioneve</b>		<b>33,034</b>	<b>36,712</b>
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	19	15,986	12,640
Shpenzimet për tarifa dhe komisione	19	(6,394)	(3,454)
Fitimi/humbja nga tregtimi		568	399
Të ardhurat neto nga instrumentet financiare në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes		429	102
Të ardhurat tjera operative	20	1,475	346
<b>Të ardhurat operative</b>		<b>45,098</b>	<b>46,745</b>
Shpenzimet e personelit	21	(11,437)	(10,811)
Shpenzime tjera operative	22	(14,344)	(15,141)
<b>Fitimi para tatimit në të ardhura</b>		<b>19,317</b>	<b>20,793</b>
Shpenzimet e tatimit në të ardhura	23	(2,325)	(2,187)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>16,992</b>	<b>18,606</b>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshi</b>			
<i>Zërat që janë apo mund të ri-klasifikohen në fitim apo humbje</i>			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare në dispozicion për shitje		10	(50)
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>17,002</b>	<b>18,556</b>

Pasqyra individuale e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse lexohet së bashku me shënimet që përbëjnë pjesë të pasqyrave individuale financiare të paraqitura në faqet 42 deri 79.

## Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

(shumat në '000 Euro)	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezerva e vlerës së drejtë	Gjithsej kapitali i aksionarëve
<b>Bilanci më 1 janar 2015</b>	63,000	59,764	-	122,764
<b>Kontributet dhe shpërndarjet</b>				
Dividentat e pronarëve të kapitalit	-	(16,000)	-	(16,000)
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	18,606	-	18,606
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	(50)	(50)
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2015</b>	63,000	62,370	(50)	125,320
<b>Kontributet dhe shpërndarjet</b>				
Dividentat e pronarëve të kapitalit	-	(19,500)	-	(19,500)
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	16,992	-	16,992
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse</b>				
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	-	10	10
<b>Bilanci më 31 dhjetor 2016</b>	63,000	59,862	(40)	122,822

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital lexohet së bashku me shënimet që përbëjnë pjesë të pasqyrave financiare individuale të paraqitura në faqet 42 deri 79.



## Pasqyra individuale e rrjedhës së parasë

(shumat në € '000)	Shënimet	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Interesi i pranuar në kredi		38,849	41,484
Interesi i paguar në plasmane		(246)	(224)
Interesi i pranuar në investimet në letra me vlerë		1,629	552
Interesi i paguar në depozita dhe kredia e varur		(3,241)	(3,657)
Tarifat dhe komisionet e pranuar		15,823	12,220
Tarifat dhe komisionet e paguara		(6,394)	(3,454)
Të ardhura tjera të pranuar		3,004	1,789
Shpenzimet e personelit të paguara		(11,425)	(11,289)
Shpenzime tjera operative të paguara		(10,785)	(13,510)
Tatimi në të ardhura i paguar		(3,500)	(3,200)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative</b>		<b>23,714</b>	<b>20,711</b>
<b>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</b>			
Rezerva e detyrueshme e likuiditetit		(1,761)	(5,318)
Kreditë dhe paradhëniet për bankat		(105)	30,506
Kreditë dhe paradhëniet për klientët		(51,312)	(3,627)
Investimet në letra me vlerë		21,622	(84,466)
Pasuri tjera		297	(149)
Detyrimet ndaj klientëve		49,933	71,339
Depozitat nga banka		(717)	(370)
Detyrimet tjera		4,448	(1,399)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>		<b>46,119</b>	<b>27,227</b>
<b>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese</b>			
Blerja e pronës, pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	12	(4,875)	(3,909)
Blerja e vartësve		(1,898)	-
<b>Neto paraaja e shfrytëzuar në aktivitete investuese</b>		<b>(3,909)</b>	<b>(2,977)</b>
<b>Neto paraaja e shfrytëzuar në aktivitete investuese</b>		<b>(6,773)</b>	<b>(3,909)</b>
<b>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese</b>			
Kthimi i huamarrjeve		(974)	(1,857)
Të ardhurat nga huamarrjet		-	-
Dividendat e shpërndara		(19,500)	(16,000)
<b>Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		<b>(20,474)</b>	<b>(17,857)</b>
Efektii i ndryshimit të normës së këmbimit valutor		(77)	165
<b>Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të parave</b>		<b>18,795</b>	<b>5,626</b>
Paraaja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	6	35,552	29,926
<b>Paraaja dhe ekuivalentët e parasë më 31 dhjetor</b>	<b>6</b>	<b>54,347</b>	<b>35,552</b>

Pasqyra individuale e rrjedhës së parasë lexohet së bashku me shënimet që përbëjnë pjesë të pasqyrave individuale financiare të paraqitura në faqet 42 deri 79.

# Shënimet për pasqyrat financiare individuale për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2016

## 1. Njësia raportuese

Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është aksionari që ka në pronësi 100 për qind të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a. Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është 100 për qind vartës indirekt i Raiffeisen Bank International AG.

Banka operon sipas licencës bankare të lëshuar nga BQK më 8 nëntor 2001. Aktivitetet kryesore afariste të Bankës janë aktivitetet bankare komerciale dhe retail brenda Kosovës.

Më 31 dhjetor 2016, Banka ka 8 degë dhe 42 nëndegë brenda Kosovës (31 dhjetor 2015: 8 degë dhe 42 nëndegë). Zyra e regjistruar e Bankës është e vendosur në adresën në vijim: Rruga UÇK nr. 51, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

## 2. Baza e përgatitjes

### 2.1 Baza e kontabilizimit

Pasqyrat individuale financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") dhe interpretimet e saj të miratuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB).

### 2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç zërave materialë në vijim:

Zërat	Baza e matjes
Pasuritë financiare në dispozicion për shitje	Vlera e drejtë
Instrumentet financiare derivative	Vlera e drejtë
Instrumentet financiare jo-derivative në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes	Vlera e drejtë

### 2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale e Bankës e përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare është euro, pasi që është valuta e mjedisit ekonomik primar në të cilin punon Banka dhe pasqyron substancën ekonomike të ngjarjeve të lidhura ("valuta funksionale"). Të gjitha shumat janë rrumbullakuar në mijëshen më të afërt, përveç kur specifikohet ndryshe.

### 2.4 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare individuale, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacionet mbi fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të konsiderueshëm në shumat e paraqitura në pasqyrat financiare individuale janë përshkruar në shënimin 3.16, 4 dhe 5.

## 3. Politikat kryesore kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë zbatuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare individuale.

### 3.1 Vartësit dhe konsolidimi

Vartësit janë njësi ekonomike të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka është e ekspozuar, ose ka të drejta, ndaj kthimit variabil nga përfshirja e saj me të investuarin (vartësin) dhe ka aftësinë të ndikojë në atë kthim përmes pushtetit të vet mbi të investuarin.

Këto pasqyra financiare paraqesin rezultatin dhe pozitën financiare vetëm të Bankës dhe nuk përfshijnë ato të vartësve të saj, siç është dhënë në detaje në shënimin 11.

Banka përgatit pasqyra financiare individuale/të veçanta në përputhje me SNRF. Është bërë përjashtim nga konsolidimi sepse Banka në vetvete është vartës tërësisht në pronësi dhe kompania amë përfundimtare Raiffeisen Bank International përgatit pasqyra financiare të konsoliduara, në dispozicion për përdorim publik në <http://www.rbinternational.com>, që janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Interesat në vartës janë llogaritur në bazë të kostos në pasqyrat financiare individuale.

### 3.2 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen me kursin në ditën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare në valutë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor si rezultat i pagesës së transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi në kursin e këmbimit në fund të vitit të pasurive dhe detyrimeve monetare në valutë të huaj paraqiten në fitim dhe humbje.

### 3.3 Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

#### (i) Klasifikimi

#### Pasuritë financiare

Banka i klasifikon pasuritë e veta financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- kreditë dhe të arkëtueshmet;
- të mbajtura deri në maturim;
- në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- në dispozicion për shitje.

Shih 3.3.1 deri në 3.3.7

#### Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, si detyrime tjera financiare. Shih 3.3.1 dhe 3.3.5

#### (ii) Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë dhe të arkëtueshmet dhe detyrimet e tjera financiare në datën në të cilën ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet tjera financiare (përfshirë blerjet e rregullta dhe shitjet e pasurive financiare) njihen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Pasuria financiare ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për zërin që nuk është me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostove të transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen apo emetimin.

### *(iii) Çregjistrimi*

Banka e çregjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuese mbi rrjedhat e parasë nga pasuria financiare mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhat monetare kontraktuese në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të pasurisë financiare janë transferuar apo në të cilin Banka as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk e mban kontrollin e pasurisë financiare.

Me çregjistrimin e pasurisë financiare, diferenca ndërmjet vlerës bartëse të pasurisë (ose vlera e bartur e ndarë për pjesën e pasurisë që po çregjistrohet) dhe shumës së konsideratës së pranuar (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar minus çdo detyrimi të ri të marrë përsipër) dhe çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim ose humbje. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për çregjistrim që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si pasuri apo detyrim i veçantë.

Banka çregjistron një detyrim financiar kur obligimet e veta kontraktuale përfundojnë apo anulohen, apo u skadon afati.

### *(iv) Kompensimi*

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare kompensohen reciprokisht dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF.

### *(v) Matja e kostos së amortizuar*

“Kostoja e amortizuar” e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është shuma me të cilën pasuria financiare ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus zbritjet eventuale për shkak të rënies në vlerë.

### *(vi) Matja e vlerës së drejtë*

“Vlera e drejtë” është çmimi që do të merrej nëse shitet një pasuri ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në tregun kryesor ose, në mungesë të tij, tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e detyrimit pasqyron rrezikun e mos performancës së tij.

Kur mundet, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet aktiv nëse transaksionet për pasurinë ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të ofruar informata për çmimet në bazë të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatës të vëzhgueshëm dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshëm. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshinë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh gjatë vendosjes së çmimit të një transaksion.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit – d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë.

Nëse banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk dëshmohet as me çmim të kuotuar në treg aktiv për një pasuri ose detyrim identik dhe as në bazë të një teknike vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të vëzhgueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, të korrigjuar për të shtyrë dallimin ndërmjet vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, ky dallim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi përkrahet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni të mbyllet. Në qoftë se një pasuri ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkesës, atëherë Banka mat pasuritë dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmimin e kërkesës.

Vlera e drejtë e depozitës sipas kërkesës nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar nga data e parë në të cilën shuma mund të kërkohet për t'u paguar. Banka njih transferet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

### *(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë*

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka dëshmi objektive që një pasuri financiare ose grup pasurish financiare është e rënë në vlerë. Pasuria financiare ose një grup pasurish financiare është e rënë në vlerë vetëm nëse ka dëshmi objektive të rënies në vlerë si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë (një 'ndodhi e humbjes') dhe që kjo ndodhi e humbjes (ose ndodhive të humbjes) ka një ndikim në rrjedhat e vlerësuar të ardhshme të parasë të pasurisë financiare ose grupit të pasurive financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Kriteret që Banka përdorë për të përcaktuar se ka dëshmi objektive të humbjes nga rënia në vlerë përfshijnë:

- Mospagesa/vonesa në pagesa në pagesat kontraktuale të principalit ose interesit;
- Vështirësi për huamarrësin në rrjedhën e tij të parave ;
- Shkelja e kushteve të kredisë;
- Inicimi i procedurave të bankrotimit;
- Përkeqësimi i gjendjes konkurruese të huamarrësit;
- Përkeqësimi i vlerës së kolateralit;

Periodha e vlerësuar ndërmjet humbjeve që ndodhin dhe identifikimi i saj përcaktohet nga menaxhmenti lokal për çdo portfolio të identifikuar. Në përgjithësi, periudhat e përdorura variojnë nga tre muaj deri në 12 muaj; në raste të jashtëzakonshme, jepen periudha më të gjata.

Banka së pari vlerëson nëse dëshmia objektive e rënies në vlerë ekziston individualisht për pasuritë financiare që janë individualisht të rëndësishme, dhe individualisht ose kolektivisht për pasuritë financiare të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse Banka përcakton se nuk ka dëshmi objektive të rënies në vlerë për një pasuri financiare të vlerësuar individualisht, qoftë e rëndësishme ose jo, ajo e përfshin pasurinë në një grup pasurish financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor dhe vlerëson në mënyrë kolektive rënie në vlerë të tyre. Pasuritë që janë vlerësuar individualisht nëse kanë rënie në vlerë dhe për të cilat ka ose vazhdon të njihet humbja nga rënia në vlerë, nuk përfshihen në vlerësim kolektiv të rënies në vlerë.

Shuma e humbjes matet si diferenca ndërmjet vlerës së bartur të pasurisë dhe vlerës aktuale të rrjedhave të ardhshme të parasë (duke përjashtuar humbjet e ardhshme kreditore që nuk kanë ndodhur) të skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë financiare. Vlera e bartur e pasurisë zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie të lejimit dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje.

Llogaritja e vlerës së tashme të rrjedhave të ardhshme të vlerësuar të parasë të një pasurie financiare të kolateralizuar pasqyron rrjedhat e parasë që mund të rezultojnë nga mbyllja e kolateralit minus kostot për marrjen dhe shitjen e kolateralit, qoftë mbyllja e mundshme apo jo.

Për qëllimet e një vlerësimi kolektiv të rënies në vlerë, pasuritë financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut kreditor (d.m.th., në bazë të procesit të vlerësimit të Bankës që shqyrton llojin e pasurisë, industrinë, vendndodhjen gjeografike, llojin e kolateralit, statusin e vonës dhe faktorë të tjerë përkatës). Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e rrjedhave të ardhshme të parasë për grupet e pasurive të tilla pasi që janë tregues të aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat e detyruara, sipas kushteve kontraktuale të pasurive që janë duke u vlerësuar.

Rrjedhat e ardhshme të parasë në një grup të pasurive financiare që vlerësohen në mënyrë kolektive për rënie në vlerë, vlerësohen në bazë të rrjedhave kontraktuale të parasë të pasurive në Bankë dhe përvojës së humbjes historike nga pasuritë me karakteristika të rrezikut kreditor të ngjashme me ato në Bankë. Përvoja e humbjes historike rregullohet/korrigjohet në bazë të të dhënave aktuale të vëzhguara, për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale, që nuk e kanë prekur periudhën në të cilën është e bazuar përvoja historike e humbjes dhe për të hequr efektet e kushteve të periudhës historike që nuk ekzistojnë aktualisht.

Vlerësimet e ndryshimeve në rrjedhat e ardhshme të parasë për grupe të pasurive pasqyrojnë dhe janë në përputhje me ndryshimet në të dhënat përkatëse të vëzhguara nga periudha në periudhë (për shembull, ndryshimet në normat e papunësisë, çmimet e pronës, statusin e pagesave, apo faktorë të tjerë tregues të ndryshimeve në probabilitetin e humbjeve në Bankë dhe përmasat e tyre). Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e rrjedhave të ardhshme të parasë rishikohen rregullisht nga Banka për të zvogëluar çfarëdo dallimi ndërmjet vlerësimit të humbjeve dhe përvojës reale/faktike të humbjeve.

Kur një kredi është e pakthyeshme/paarkëtueshme, ajo shlyhet kundrejt provizionit përkatës për rënie në vlerë të kredisë. Kredi të tilla shlyhen pasi të gjitha procedurat e nevojshme kanë përfunduar dhe shuma e humbjes është përcaktuar.

Në qoftë se, në një periudhë të mëvonshme, shuma e humbjes nga rënia në vlerë zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi që është njohur rënia në vlerë (siç mund të jetë përmirësimi i vlerësimit kreditor të debitorit), humbja nga rënia në vlerë e njohur më parë stornohet duke rregulluar llogarinë e lejimit. Shuma e stornimit njihet në fitim apo humbje kundrejt rënies në vlerë të ngarkuar për humbjet e kredisë.

Humbjet nga rënia në vlerë në investimet në letra me vlerë në dispozicion për shitje njihen përmes ri-klasifikimit të humbjeve të akumuluar në rezervën e vlerës së drejtë në ekuitet, në fitim apo humbje. Humbja e akumuluar që ri-klasifikohet nga ekuiteti në fitim apo humbje është dallimi ndërmjet kostos së blerjes, neto nga (përfshirë neto) ri-pagesa e principalit dhe amortizimi, dhe vlerës aktuale të drejtë, minus humbja në vlerë e njohur paraprakisht në fitim apo humbje. Ndryshimet në humbjen në vlerë që i atribuohen aplikimit të metodës së interesit efektiv reflektohen si komponent i të ardhurave nga interesi.

Nëse, në një periudhë pasuese, vlera e drejtë e një instrumenti borxhi në dispozicion për shitje, që ka pësuar rënie në vlerë rritet dhe rritja mund të ndërlidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodhë pas njohjes së humbjes në vlerë, atëherë humbja nga rënia në vlerë anulohet nëpërmjet fitimit apo humbjes; përndryshe, çdo rritje në vlerën e drejtë njihet nëpërmjet OCI (të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse). Çdo kthim/rikuperim pasues në vlerën e drejtë të një instrumenti kapitali në dispozicion për shitje, që ka pësuar rënie në vlerë, njihet gjithmonë në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

### 3.3.1 Pasuritë financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori: pasuritë financiare të mbajtura për tregtim ("pasuritë për tregtim"), duke përfshirë instrumentet derivative të mbajtura, dhe pasuritë financiare të përcaktuara në fillim me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Banka nuk zbaton kontabilitetin mbrojtës. Banka ka përcaktuar pasuritë financiare dhe detyrimet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në cilëndo nga rrethanat e mëposhtme:

- Pasuritë ose detyrimet menaxhohen, vlerësohen dhe raportohen së brendshmi në bazën e vlerës së drejtë;
- Përcaktimi eliminon ose ul ndjeshëm mospërputhjet kontabël që do të lindnin përndryshe;

a) Pasuritë financiare që mbahen për tregtim

Një pasuri financiare klasifikohet si e mbajtur për tregtim në qoftë se ajo është blerë ose krijuar në rend të parë për qëllimin e shites ose riberjes në periudhën afatshkurtër, ose në qoftë se ajo është pjesë e një portfolio të instrumenteve financiare të identifikuar që menaxhohen së bashku dhe për të cilat ka dëshmi të një modeli të kohës së fundit real të fitimeve afatshkurtra. Derivatet kategorizohen njëjtë si të mbajtura për tregtim përveç nëse ato janë përcaktuar si instrumente mbrojtëse (hedging instruments).

b) Të caktuara në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare përcaktohen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes kur:

- Kjo konsiderueshëm i zvogëlon mospërputhjet e matjes që do të lindnin, nëse instrumentet e lidhura trajtohen si të mbajtura për tregtim dhe instrumentet financiare bazë regjistrohen në koston e amortizuar për kreditë dhe paradhëniet për klientët apo bankat dhe letrat me vlerë të lëshuara
- Disa investime, të tilla si investimet e kapitalit, menaxhohen dhe vlerësohen mbi bazën e vlerës së drejtë në përputhje me një strategji të dokumentuar të rrezikut ose investimit dhe të raportuar te personeli kryesor i menaxhmentit në atë bazë dhe përcaktohen me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes; dhe
- Instrumentet financiare, të tilla si letra me vlerë të borxhit, që përmbajnë një ose më shumë instrumente derivative të përfshira që konsiderueshëm modifikojnë rrjedhën e parasë, përcaktohen me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes

### 3.3.2 Pasuritë financiare në dispozicion për shitje

• Investimet në dispozicion për shitje janë investime jo-derivative që përcaktohen si në dispozicion për shitje ose nuk janë klasifikuar si një kategori tjetër e pasurive financiare. Investimet në dispozicion për shitje përfshijnë instrumentet e borxhit

• Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga dividendët njihen në fitim ose humbje kur Banka fiton të drejtën për dividend. Fitimet ose humbjet nga këmbimet valutore të investimeve në instrumente borxhi në dispozicion për shitje njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

• Ndryshimet tjera në vlerën e drejtë njihen në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse dhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë brenda kapitalit. Kur investimi shitet, fitimi ose humbja e akumuluar në ekuitet riklasifikohet në fitim ose humbje.

### 3.3.3. Kreditë dhe paradhëniet

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk kuotohen në një treg aktiv. Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe kreditë dhe paradhëniet për klientët klasifikohen si kredi dhe të arkëtueshme. Të gjitha kreditë dhe paradhëniet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke qenë para të dhëna si paradhënie për huamarrësit. Pas njohjes fillestare, ato më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çfarëdo kosto të emetimit/lëshimit dhe çfarëdo zbritje ose premi në pagesë.

Kreditë dhe paradhëniet raportohen neto nga provizionet për humbje nga kreditë.

Kur Banka blen një pasuri financiare dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë pasuri (ose një pasuri kryesisht të ngjashme) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo e anasjelltë), marrëveshja regjistrohet si kredi apo paradhënie, dhe pasuria nuk paraqitet në pasqyrat financiare individuale të Bankës.

### 3.3.4 Investimet e mbajtura deri në maturim

Investime të mbajtura deri në maturim janë investimet në obligacionet e qeverisë që Banka ka qëllimin dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Investimet e mbajtura deri në maturim barten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga rënia në vlerë. Shitja ose riklasifikimi i një shume më të madhe se sa insignifikante e investimeve të mbajtura deri në maturim do të kishin si rezultat riklasifikimin e të gjitha investimeve të mbajtura deri në maturim si në dispozicion për shitje, dhe Banka nuk do të mund të klasifikonte investimet si të mbajtura deri në maturim gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare të ardhshme.

### 3.3.5 Instrumentet financiare derivative

Instrumentet derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën në të cilën lidhet kontrata derivative dhe më pas maten me vlerën e tyre të drejtë. Vlerat e drejta merren nga çmimet e kuotuar të tregut në tregje aktive, duke përfshirë edhe transaksionet e fundit të tregut, dhe teknikat e vlerësimit, duke përfshirë modele të rrjedhave të skontuara të parasë sipas rastit. Të gjithë derivativët barten si pasuri kur vlera e drejtë është pozitive dhe si detyrime kur vlera e drejtë është negative. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve përfshihen në "Të ardhurat neto nga instrumentet financiare në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes" në fitimin ose humbjen e periudhës.

Banka përdor instrumentet financiare derivative të tillë si kundërkëmbime të normave të interesit që blihen në treg (OTC) për të menaxhuar rrezikun që del nga luhatjet e normave të interesit të tregut. Për instrumentet derivative nuk zbatohet kontabiliteti mbrojtës.

### 3.3.6 Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezervat e detyrueshme

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedhat dhe monedhat (përfshirë rezervat e kufizuara – shih më poshtë), bilancet e pakushtëzuara bankare të mbajtura në bankat qendrore dhe pasuritë financiare shumë likuide me maturitet fillestar tre muaj ose më pak nga data e blerjes që janë objekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e zotimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen sipas koston së amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar (bilanci).

### 3.3.7 Rezervat e detyrueshme të likuiditetit

Në përputhje me rregullat e BQK-së, Banka duhet të përmbushë kërkesën mesatare minimale të likuiditetit. Kërkesa e likuiditetit llogaritet në baza javore si 10 për qind e bazës së depozitave, e përcaktuar si mesatare e gjithsej detyrimeve të depozitave për publikun jo-bankar në euro dhe valuta të tjera, gjatë ditëve të punës së periudhës së mirëmbajtjes. Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në euro në BQK dhe 50 për qind e ekuivalentin e parave në euro në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat në BQK nuk duhet të jenë më pak se 5 për qind e bazës së zbatueshme të depozitave. Përderisa pasuritë përkatëse likuide nuk janë në dispozicion për të financuar aktivitetet e përditshme të Bankës, ato janë përjashtuar nga paraja dhe ekuivalentët e parasë për qëllime të pasqyrës së rrjedhjes së parasë.

## 3.4 Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet paraqiten me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar, nëse ka.

Kostot pasuese përfshihen në vlerën bartëse të pasurisë apo njihen si pasuri të ndara, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me artikullin do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e artikullit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera i ngarkohen shpenzimeve tjera operative gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Vlerat bartëse të pronës dhe pajisjeve rishikohen për rënie në vlerë kur ngjarjet ndryshojnë apo ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera e bartur mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ka indikacione të tilla dhe ku vlerat bartëse tejkalojnë shumën e rikuperueshme të vlerësuar, pasuritë ose njësitë gjeneruese të parasë (CGU) shlyhen deri në vlerën e tyre të realizueshme.

Shuma e rikuperueshme e pronës dhe pajisjeve është më e larta ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhat e ardhshme të parasë skontohehen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut të vlerës kohore të parasë dhe rreziqet specifike për ato pasuri.

Për një pasuri që nuk krijon rrjedha të parasë të pavarura, shuma e rikuperueshme/realizueshme përcaktohet për njësitë krijuese të parasë (CGU) të cilave i përketin pasuritë. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim apo humbje.

Zhvlërësimi i pasurive ngarkohet në bazë të metodës lineare në normat e përcaktuara për të shpërndarë koston e pronës dhe pajisjeve mbi jetëgjatësinë e tyre të përdorimit. Normat vjetore të zhvlërësimit përcaktohen nga jetëgjatësia e vlerësuar e pasurive të caktuara sipas tabelës më poshtë:

Përmirësimet e pronës me qira zhvlërësohen mbi më të ulëtën ndërmjet jetëgjatësisë dhe afatit të qirasë.

Bankomatët, pajisjet tjera të bankës dhe zyrës	5 vjet
Pajisjet kompjuterike	3 vjet
Metodat e zhvlërësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit.	

### 3.5 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme njihen nëse është e mundshme (probabile) se përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen pasurisë do të hyjnë në Bankë dhe kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Pasuritë e paprekshme fillimisht maten me kosto. Vlerat bartëse të pasurive të paprekshme rishikohen për rënie në vlerë, kur ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera bartëse mund të mos jetë e rikuperueshme/realizueshme. Pasuritë e paprekshme përbëhen tërësisht nga programe kompjuterike që amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar prej pesë vjet dhe licencave që amortizohen gjatë afatit të licencës.

### 3.6 Prona e rimarrë në posedim

Në rrethana të caktuara, prona rimerret në posedim pas mbylljes së kredive që nuk janë paguar. Pasuritë e tilla maten në vlerën më të ulët të shumës së tyre bartëse dhe vlerës neto të realizueshme.

### 3.7 Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, zbritur kostot e transaksioneve të kryera. Huamarrjet deklarohen më pas me koston e amortizuar; çdo dallim ndërmjet të ardhurave, zbritur (përfjashtuar-net of) kostot e transaksionit dhe vlerës së kthimit njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### 3.8 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të mëparshme, Banka ka një detyrim të tashëm ligjor ose të krijuar që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që do të duhen të hargjohen të mira ekonomike për të mbuluar detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të pritshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike ndaj detyrimit. Lëshimi i skontimit njihet si kosto financiare.

Detyrimet kontingjente mund të zhvillohen në një mënyrë që nuk është pritur fillimisht. Prandaj ato vlerësohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse dalja e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është bërë e mundshme. Në rast se detyrimi kontingjent ka si rezultat një detyrim aktual që mund të matet me besueshmëri, duhet të regjistrohet në bilanc provizioni për shumën. Vetëm zotimet e pakthyeshme shkaktojnë rrezik kreditor, pra vetëm kontingjentat dhe zotimet e pakthyeshme mund të jenë objekt i provizionimit. Për ekspozimet e mëdha, vlerësimi bëhet në mënyrë individuale. Në rast të vlerësimit të bazuar në portfolio, ndërtimi i portfolios dhe llogaritja e provizioneve të bazuara në portfolio llogariten siç tregohet në rënie në vlerë të kredive dhe paradhënive.

### 3.9 Beneficionet e punëtorëve

Banka paguan vetëm kontributet për planin pensional të administruar publikisht në baza të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihet si shpenzim i beneficioneve të punëtorëve në kohën kur ato duhet të paguhet.



### 3.10 Kapitali aksionar

Dividendët në aksionet e zakonshme njihen në ekuitet në periudhën në të cilën ato janë aprovuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit shpalosen si ngjarje pas fundit të periudhës së raportimit.

### 3.11 Rezervat e ekuitetit

Rezervat e regjistruara në ekuitet (OCI) në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës përfshijnë:

- Rezervën në dispozicion për shitje, që përfshinë ndryshimet në vlerën e drejtë të investimeve në dispozicion për shitje

### 3.12 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentet financiare që bartin interes njihen në fitim ose humbje të periudhës në 'të ardhurat nga interesi' dhe 'shpenzimet e interesit' duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një pasurie financiare ose një detyrimi financiar dhe e shpërndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që zbritet saktësisht pagesat e ardhshme në para ose arkëtimet përgjatë jetëgjatësisë së pritit të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër për vlerën bartëse neto të pasurisë financiare ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës së interesit efektiv, Banka vlerëson rrjedhat e parasë duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por nuk merr parasysh humbjet e ardhshme kreditore.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin kostot e transaksionit dhe tarifat dhe pagesat e paguara ose të pranura që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një pasurie financiare ose detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi i paraqitur në fitim apo humbje përfshijnë:

- interesin në pasuritë financiare dhe detyrimet financiare të matur në kosto të amortizuar të llogaritur në bazë të interesit efektiv; dhe
- interesin në letrat me vlerë të investimeve në dispozicion për shitje të llogaritur në bazë të interesit efektiv.

### 3.13 Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një pasuri financiare ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhurat tjera nga tarifat dhe komisionet - duke përfshirë tarifat e shërbimeve të llogarisë, komisionet e shitjeve, tarifat e plasimit - njihen kur shërbimet përkatëse të kryhen. Në qoftë se një zotim për kredi nuk pritët të ketë si rezultat tërheqjen e një kredie, atëherë tarifat përkatëse të zotimit të kredisë njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së zotimit. Shpenzimet tjera për komisionet dhe tarifat lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që pranohen shërbimet.

### 3.14 Qiratë operative

Pagesat e bëra për qira operative ngarkohen në shpenzime në bazë të metodës lineare gjatë jetëgjatësisë së qirasë. Kur një qira operative përfundon para kohës së përfundimit të qirasë, pagesat që kërkohet të bëhen për qiradhënesin si dënim njihen si shpenzim në periudhën në të cilën ndodh ndërprerja.

### 3.15 Të ardhurat neto nga instrumentet tjera financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes

Të ardhurat neto nga instrumentet tjera financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes ndërlidhen me derivativët jo të tregtueshëm mbajtur për qëllime të menaxhimit të rrezikut që nuk përbëjnë pjesë të raporteve kualifikuese mbrojtëse dhe pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes. Përfshinë të gjitha ndryshimet e realizuara dhe të porealizuara të vlerës së drejtë, interesin, dividendat dhe ndryshimet në këmbimin valutor.

### 3.16 Tatimi në të ardhura

Tatimi në të ardhura përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Ai njihet në fitim ose humbje me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

### *Tatimi aktual*

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen e vitit dhe korrigjimet e tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Ai matet duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit.

### *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës bartëse të pasurive dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me norma të tatimit që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të kthehen prapa, në bazë të ligjeve që janë miratuar ose substantivisht janë miratuar në datën e raportimit. Pasuria tatimore e shtyrë njihet vetëm deri në masën ku është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundrejt të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme. Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Pasuritë tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në masën ku nuk është më mundshme (probabile) që përfitimet e lidhura nga tatimi dhe detyrimi tatimor, respektivisht do të realizohen.

Tatimet shtesë mbi të ardhura që dalin nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për ta paguar dividendin përkatës.

## **3.17 Standardet dhe interpretimet që janë nxjerrur por ende nuk janë aprovuar**

Standardet dhe interpretimet e nxjerra por akoma të paaprovuara deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të bankës janë shpalosur më poshtë. Banka synon që të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur të hyjnë në fuqi.

### *SNRF 9 Instrumentet Financiare*

Në korrik të vitit 2014, IASB nxjerri versionin final të SNRF 9 Instrumentet Financiare që zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet paraprake të SNRF 9. SNRF 9 përbashkon të tre aspektet e kontabilitetit për projektin e instrumenteve financiare: klasifikimin dhe matjen, rënien në vlerë dhe kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2018, ku lejohet aplikimi i më i hershëm. Përveç kontabilitetit mbrojtës, kërkohet edhe aplikimi retrospektiv, por ofrimi i informacioneve krahasuese nuk është i detyrueshëm. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkesat në përgjithësi aplikohen në mënyrë prospective, me disa përjashtime të kufizuara.

Banka planifikon adoptimin e standardit të ri në datën e kërkuar të hyrjes në fuqi. Banka është në proces të kryerjes së një vlerësimi të nivelit të lartë të ndikimit për të trija aspektet e SNRF 9. Ky vlerësim paraprak bazohet në informacionet aktualisht në dispozicion dhe mund t'i nënshtrohet ndryshimeve që dalin nga analizat e mëtejshme të detajuara apo informacionet shtesë të arsyeshme dhe të mbështetshme që vihen në dispozicion të Bankës në të ardhmen.

#### **(a) Klasifikimi dhe matja**

Banka nuk pret ndonjë ndikim të konsiderueshëm në bilancin e gjendjes apo ekuitetin, me zbatimin e kërkesave të klasifikimit dhe matjes që dalin nga SNRF 9. Pritet të vazhdojë matjen në vlerë të drejtë të të gjitha pasurive financiare që aktualisht mbahen në vlerë të drejtë.

Kreditë dhe të arkëtueshmet mbahen për të mbledhur rrjedhat kontraktuale të parasë dhe pritet të sjellin rrjedha të parasë që paraqesin vetëm pagesat e principalit dhe interesit, përveç për kreditë e papaguara për të cilat banka do të përftojë rrjedhat e saj të parasë nga ekzekutimi i kolateraleve. Në këtë mënyrë, banka pret që këto do të vazhdojnë të maten në kosto të amortizuar sipas SNRF 9. Megjithatë, banka do të analizojë karakteristikat kontraktuale të rrjedhës së parasë të atyre instrumenteve në mënyrë më të detajuar para se të përfundojë nëse të gjitha ato instrumente plotësojnë kriteret për matje të koston të amortizuar sipas SNRF 9.

#### **(b) Rënia në vlerë**

SNRF 9 kërkon që banka të regjistrojë humbjet e pritura nga kreditë për të gjitha instrumentet e saj të borxhit, kreditë dhe të arkëtueshmet nga tregtia, qoftë në baza 12 mujore apo gjatë gjithë kohëzgjatjes.

Banka do të duhet të bëjë një analizë më të detajuar që merr parasysh të gjitha informacionet e arsyeshme dhe të mbështetshme, duke përfshirë elementet progresive për të përcaktuar masën e ndikimit, për të vlerësuar ndikimin e plotë të standardit të ri.

### (c) Kontabiliteti mbrojtës

Banka beson që të gjitha raportet ekzistuese të mbrojtjes që aktualisht janë të përcaktuara në raportet efektive të mbrojtjes akoma do të kualifikohen për kontabilitet mbrojtës sipas SNRF 9. Pasi që SNRF 9 nuk ndryshon parimet e përgjithshme mbi atë se si një subjekt kontabilizon mbrojtjet efektive, banka nuk pret ndikim të konsiderueshëm si rezultat i aplikimit të SNRF 9.

#### *SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me klientët*

SNRF 15 është lëshuar në maj të vitit 2014 dhe vendos një model prej pesë hapave për të kontabilizuar të hyrat që shfaqen nga kontratat me klientët. Sipas SNRF 15, të hyrat njihen në një shumë që reflekton konsideratën (shumën) në të cilën subjekti pritët të marrë të drejtën, si shkëmbim për transferin e mallrave apo shërbimeve tek një klient.

Standardi i ri i të hyrave do të zëvendësojë të gjitha kërkesat aktuale për njohjen e të hyrave sipas SNRF. Për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2018, kërkohet ose zbatimi i plotë retrospektiv ose zbatimi i modifikuar retrospektiv, kur IASB finalizon ndryshimet e tyre për të shtyrë datën e hyrjes në fuqi të SNRF 15 për një vit. Lejohet adoptimi më i hershëm. Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga SNRF 15.

#### *SNK 7 Iniciativa e Shpalosjes – Ndryshimet në SNK 7*

Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e Rrjedhës së Parasë janë pjesë e Iniciativës së Shpalosjes së IASB dhe kërkojnë që një subjekt të ofrojë shpalosje që iu mundësojnë përdoruesve të pasqyrave financiare që të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet që dalin nga aktivitetet financiare, përfshirë si ndryshimet që dalin nga rrjedhat e parasë ashtu dhe ndryshimet jo në para. Në zbatimin fillestar të ndryshimit, subjekteve nuk u kërkohet që të ofrojnë informacione krahasuese për periudhat paraprake. Këto ndryshime janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2017, ku lejohet aplikimi më i hershëm.

#### *SNRF 16 Qiratë*

SNRF 16 është nxjerrë në janar të vitit 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiratë, IFRIC 4 Përcaktimi nëse një marrëveshje përmban një qira, SIC-15 Qiratë Operative – Incentivat dhe SIC-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe shpalosjen e qirave dhe kërkon nga qiramarrësit që të kontabilizojnë të gjitha qiratë në një model të vetëm bilancor të ngjashëm me kontabilizimin e qirave (lizingut) financiare sipas SNK 17. Standardi përfshinë dy përfshajtme të njohjes për qiramarrësit – qiratë e pasurive të “vlerës së ulët” (p.sh., kompjuterët personal) dhe qiratë afatshkurtra (d.m.th., qiratë me afat të qirasë prej 12 muajve apo më pak). Në datën e fillimit të një qiraje, qiramarrësi do të pranojë detyrimin për të bërë pagesat e qirasë (d.m.th. detyrimi i qirasë) dhe një pasuri që paraqet të drejtën për të shfrytëzuar pasurinë e lidhur gjatë afatit të qirasë (d.m.th. e drejta për shfrytëzimin e pasurisë). Qiramarrësit duhet të njohin në mënyrë individuale shpenzimin nga interesi në detyrimin e qirasë dhe shpenzimin nga zhvlerësimi në të drejtën për shfrytëzimin e pasurisë.

Qiramarrësit gjithashtu kërkohen të ri-matin detyrimin e qirasë pas ndodhjes së ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që rezultojnë nga ndryshimi në një indeks apo normë të përdorur për përcaktimin e pagesave të tilla). Qiramarrësi do të njoh në përgjithësi shumën e ri-matjes të detyrimit të qirasë si një përshtatje në të drejtën për shfrytëzimin e pasurisë.

Kontabiliteti i qiradhënësit sipas SNRF 16 nuk ndryshon përmbajtësisht nga kontabiliteti i tashëm sipas SNK 17. Qiradhënësi do të vazhdojë që të klasifikojë të gjitha qiratë duke përdorur të njëjtin parim të klasifikimit si në SNK 17 dhe dallon dy lloje të qirave: qira operative dhe financiare. SNRF 16 gjithashtu kërkon nga qiramarrësit dhe qiradhënësit që të bëjnë më shumë shpalosje se sa sipas SNK 17.

SNRF 16 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2019. Lejohet zbatimi më i hershëm, por jo para se një subjekt të zbatojë SNRF 15. Qiramarrësi mund të zgjedh që të zbatojë standardin duke përdorur qoftë një qasje të plotë retrospektive apo qasje të modifikuar retrospektive. Dispozitat kalimtare të përfshira në standard lejojnë lehtësime të caktuara. Në vitin 2017, Banka planifikon të vlerësojë efektet e mundshme të SNRF 16 në pasqyrat e saj financiare.

### 3.18 Standardet dhe interpretimet e reja ose të rishikuara

#### *Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38: Sqarimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit*

Ndryshimet e qartësojnë parimin në SNK 16 dhe SNK 38 që të hyrat pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që gjenerohen nga operimi i një biznesi (pjesë e të cilit është aset) sesa nga përfitimet ekonomike që harxhohen përmes përdorimit të asetit. Si rezultat, një metodë e bazuar në të hyrat nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar pasuritë e pa-

tundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet si dhe mund të përdoret vetëm në rrethana shumë të kufizuara për amortizimin e asetëve jo-të prekshme. Ndryshimet janë efektive në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, ku lejohet miratimi më i hershëm. Këto amendamente nuk pritet të kenë ndonjë ndikim për Bankën duke pasur parasysh që Banka nuk ka përdorur një metodë të bazuar në të hyrat për t'i zhvlerësuar asetet e saj afatgjata.

### **Ndryshimet në SNK 1 Iniciativa për dhënie të informacioneve shpjeguese/shpalosje**

Ndryshimet në SNK 1 më shumë qartësojnë së që ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet qartësojnë:

- Kërkesat e materialitetit në SNK 1
- Se zërat e linjave specifike në pasqyrën/pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe ardhurave tjera gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar (bilanci) mund të ndahen/disagregohen
- Se subjektet kanë fleksibilitet sa i përket rendit në të cilin i paraqesin shënimet për pasqyrat financiare
- Se pjesa e ATGJ-së së pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta të kontabilizuara duke përdorur metodën e kapitalit duhet të paraqiten në total si një zë i linjës së vetme, dhe të klasifikohen mes atyre zërave që do të klasifikohen apo jo më pastaj në fitim ose humbje.

Për më tepër, ndryshimet qartësojnë kërkesat që aplikohen kur nën-totalet shtesë paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën/pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe ATGJ-së. Këto amendamente nuk kanë ndonjë ndikim në Bankë.

### **Cikli i përmirësimeve vjetore 2012-2014**

Këto përmirësime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016. Ato përfshijnë:

#### **SNRF 5 Asetet afatgjata që mbahen për t'u shitur dhe operacionet jo të vijueshme**

Asetet (ose grupet e tjetërsuara) në përgjithësi tjetërsohen përmes shitjes ose shpërndarjes tek pronarët. Ndryshimi sqaron se ndërrimi nga njëra prej këtyre metodave të tjetërsimit e tek tjetra nuk do të konsiderohet si një plan i ri i tjetërsimit, por më tepër konsiderohet si një vazhdim i planit fillestar.

#### **SNRF 7 instrumentet financiare: dhënia e informacioneve shpjeguese**

##### **a. Kontratat e shërbimeve**

Ndryshimi sqaron se një kontratë e shërbimeve që përfshin një tarifë mund të përbëjë përfshirje të vazhdueshme në një aset financiar. Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë natyrën e tarifës dhe aranzhimit duke e krahasuar me udhëzuesit për përfshirje të vazhdueshme në SNRF 7, në mënyrë që të vlerësojë nëse kërkohet dhënia e informacioneve shpjeguese. Vlerësimi se cilat kontrata të shërbimeve përbëjnë përfshirje të vazhdueshme duhet të bëhet në mënyrë retrospektive. Megjithatë, dhënia e kërkuar e informacioneve shpjeguese nuk do të kërkohej të sigurohej për cilëndo periudhë që fillon përpara periudhës vjetore në të cilën njësi ekonomike zbaton ndryshimet për herë të parë.

##### **b. Zbatueshmëria e ndryshimeve të SNRF 7 për pasqyrat e përmbledhura financiare të ndërmjetme**

Ndryshimi sqaron se kërkesat kompensuese për dhënie informacionesh shpjeguese nuk zbatohen për pasqyrat e përmbledhura financiare të ndërmjetme, përveç nëse dhënie/shpalosjet e tilla sigurojnë një përditësim të konsiderueshëm në informacionin e raportuar në raportin më të fundit vjetor. Banka nuk përgatit pasqyra të përmbledhura financiare të ndërmjetme.

#### **SNK 19 Përfitimet/beneficionet e punonjësve**

Ndryshimi sqaron se gjerësia e tregut të obligacioneve shumë cilësore të korporatave vlerësohet më shumë në bazë të valutës në të cilën obligacioni është denominuar sesa vendit ku është i vendosur obligacioni. Kur nuk ka treg të gjerë për obligacione shumë cilësore të korporatave në atë valutë, atëherë përdoren vlerat e obligacioneve qeveritare.

Standarde të tjera që janë lëshuar ose rishikuar kohët e fundit por të cilat nuk janë të zbatueshme për Bankën përfshijnë:

- SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm
- SNRF 14 Llogaritë Rregullatore të Shtyrjes
- Ndryshimet në SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta: Kontabiliteti për blerjet e interesave
- Ndryshimet në SNK 27 Metoda e Kapitalit Neto në Pasqyrat Financiare Individuale

### **3.19 Vlerësimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit**

Banka bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në ato rrethana.

#### a) Ngarkesa për humbjet nga rënia në vlerë e kredive

Banka rishikon portfolion e kredisë për të vlerësuar rënien në vlerë të paktën çdo tre muaj. Në përcaktimin nëse humbja nga rënia në vlerë duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave, Banka bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregon se ka ulje të ndjeshme të rrjedhave të ardhshme të vlerësuara të parave nga një portfolio e kredive para se ulja të mund të identifikohet në një kredi specifike të asaj portfolioje. Kjo dëshmi mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve të Bankës, apo kushtet ekonomike lokale ose kombëtare që lidhen me mungesat në pasuritë e Bankës.

Menaxhmenti përdor vlerësimet e bazuara në përvojën historike për humbjet nga pasuritë me karakteristika të rrezikut kreditor dhe dëshmi objektive të rënies në vlerë të ngjashme me ato në portfolio, kur caktojnë rrjedhat e ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si shumë ashtu edhe kohën e rrjedhave të ardhshme të parave rishikohen rregullisht për të zvogëluar diferencat ndërmjet vlerësimeve të humbjes dhe përvojës aktuale të humbjes. Një aset financiar (apo një grup asetesh financiare) ka pësuar rënie në vlerë dhe humbjet nga rënia në vlerë njihen, nëse, dhe vetëm nëse, ka një evidencë objektive të rënies në vlerë si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të asetit (një "rast humbjeje") dhe që ky rast humbjeje ka një ndikim në rrjedhën e vlerësuar të parave në të ardhmen e asetit financiar të grupit të asetëve financiare që mund të maten me besueshmëri. Mund të mos jetë e mundur të identifikohet një ngjarje e vetme, diskrete që ka shkaktuar rënien në vlerë. Gjasa më e lartë është që efekti i kombinuar i disa ngjarjeve mund të ketë shkaktuar rënien në vlerë. Megjithatë, ngjarja që sjell humbje duhet të ketë një efekt të saktë të matjes në vlerën e tashme të rrjedhës së ardhshme të parasë dhe të mbështetet nga të dhëna aktuale të vëzhguara. Një evidencë objektive që një aset financiar ose grup asetesh ka pësuar rënie në vlerë përfshin të dhënat e mbikëqyrura që futen në vëmendjen e mbajtësit të pasurisë për ngjarjet e mëposhtme (ngjarjet nxitëse):

##### Portfolio Retail:

- Llogaritë të cilat kanë kaluar ndonjëherë në 180+ ditë vonesa – llogaritë me status absorbues
- Humbjet e hershme: mashtrime, klientët e vdekur, falimentimet
- Kreditë e ristrukturuara: "re-agings", shtyrje, "rewrites" (modifikimet) dhe zgjatjet e afateve

##### Portfolio Jo-Retail:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit
- një shkelje e kontratës ligjore
- njohje e dështimit, për shkak të vonesë-pagesave të interesit apo pagesës së principalit
- huadhënësi, për shkaqe ekonomike apo ligjore mbështetur në vështirësitë financiare të huamarrësit, i lejon atij koncesion, që huadhënësi në raste normale nuk do ta merrte në konsideratë: faljen e pagesave të principalit, faljen e interesit
- gjasat janë që huamarrësi do të falimentojë apo të hyjë në bankrotim apo riorganizim tjetër financiar duke përfshirë mbylljen nga shitja
- zhdukja e një tregu aktiv për atë aset financiar, për shkak të vështirësive financiare
- Komiteti Kreditor i Bankës, klasifikon një aset/grup asetesh me karakteristika të ngjashme të riskut kreditor si problematike, ku ngjarjen e referon tek "Problem Loan Committee" (edhe pse klienti nuk e përmbush vlerësimin e klientit/vlerësimin e hipotekës për klasifikim të tillë)
- ekspozimi tashmë është klasifikuar si "problematik" apo është trajtuar/analizuar nga "Problem Loan Committee".

Nëse është përcaktuar se nuk ka evidencë objektive të rënies në vlerë për një aset individual, atëherë asetit përfshihet në një grup asetesh financiare me karakteristika të ngjashme të riskut dhe banka kolektivisht i vlerëson ato për rënie në vlerë. Arsyeja për këtë qasje është se rënia në vlerë që nuk mund të identifikohet me një kredi individuale mund të jetë e identifikueshme në bazë të portfolios.

Asetet që vlerësohen individualisht për rënie në vlerë dhe identifikohen si të zhvlerësuara përjashtohen nga vlerësimi i rënies në vlerë në bazë të portfolios. Për qëllime të vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit, asetet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut kreditor, të cilat janë indikator i aftësisë së huamarrësit për të paguar të gjitha shumatat në përputhje me kushtet kontraktuale.

Portfolio Retail klasifikohet në bazë karakteristikave të llojeve të produkteve, për Individët Privatë dhe Subjektet Mikro. Për shkak të të dhënave të kufizuara historike, banka nuk ka mundur të zhvillojë modele të brendshme statistikore për të gjitha kreditë e Individëve Privatë dhe Mikro-Ndërmarrjeve. Prandaj, banka ka përdorur tri qasje për provizionimin e humbjeve nga kreditë bazuar në portfolio:

- Qasjen e bazuar në vlerësimet e brendshme - për produktet ku Banka ka statistika të mjaftueshme historike
- Modelin e normës së rrjedhës - në bazë të grupimeve (shportave) të ditëvevonesave dhe
- Krahasimet me standarde brenda Grupit - për produkteve për të cilat nuk kemi mundur të mbledhim të dhëna të mjaftueshme historike

Megjithatë, në vitet e fundit banka akumuloi historik të mjaftueshëm dhe të dhëna për vonesat/dështimet dhe humbjet. të cilat ia mundësuan bankës që të zhvillojë modele të brendshme të vlerësimit të kredive Basel 2. Prandaj, banka aktualisht ka në zbatim modelet e brendshme statistikore për portfolion Mikro (me përjashtim të kredit kartelave) dhe për produktin Kredi Personale të segmentit PI. Aktualisht, 98 për qind e portfolios Mikro dhe 82 për qind e portfolios PI janë të mbuluar me modele të brendshme. Kartelat e kreditit të segmentit MI dhe produktet e segmentit PI përveç Kredive Personale provizionohen bazuar në Modelin e Normës së Rrjedhës apo Krahasimit bazuar në kategorive e ditëve me vonesë, të renditura si më poshtë:

- Aktuale 0 ditë
- 1 deri në 30 ditë
- 31 deri në 60 ditë
- 61 deri në 90 ditë
- 91 deri në 120 ditë
- 121 deri në 150 ditë
- 151 deri në 180 ditë
- Mbi 180 ditë

Për Portfolion Jo-Retail, Raiffeisen Bank në Kosovë përdor vlerësimin e klientëve sipas RBI, si karakteristikë e rrezikut kreditor që shërben si indikator i aftësisë së huamarrësit për ripagim/përmbushje të obligimit kreditor. Llogaritë e korporatave klasifikohen duke u bazuar në modelin e vlerësimit për korporata (nga 1A deri në 10C), përderisa llogaritë e Bizneseve të Vogla dhe të Mesme ("SMB") klasifikohen duke u bazuar në modelin e vlerësimit për SMB (nga 4B deri në 10A). Llogaritë "joperformuese" të vlerësuar në klasën 10 do të aplikohet modeli për vlerësimin individualisht për rënie në vlerë.

Modeli i provizionimit të SMB dhe korporatave është i bazuar në Vlerësimin e Klientëve si dhe zbatohen HDR-të përkatëse që rrjedhin nga statistikatat e RBI-së.

#### *b) Rënia në vlerë e investimeve në dispozicion për shitje*

Banka përcakton se investimet në dispozicion për shitje zhvlerësohen kur ka pasur një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur në vlerën e drejtë nën koston e tyre. Ky përcaktim i asaj se çka është e rëndësishme ose e zgjatur kërkon gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson në mesin e faktorëve të tjerë, paqëndrueshmërinë normale në çmimin e aksionit sipas rastit. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm, kur ka prova të përkeqësimit në performancën e të investuarit, industrisë dhe të sektorit, ndryshimet në teknologji, dhe rrjedhave të parasë operative dhe financuese.

## **4. Menaxhimi i rrezikut financiar**

### **4.1 Përmbledhje**

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga shfrytëzimi i instrumenteve financiare:

- rreziku kreditor
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operativ

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit nga rreziqet më lart, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

#### **Korniza e menaxhimit të rrezikut**

Kontrollet e brendshme dhe mjete tjera të kontrollit të rrezikut të vendosura nga menaxhimi i rrezikut i Raiffeisen International mundësojnë menaxhimin e kontrolluar të rrezikut të Bankës. Mjetet kryesore të menaxhimit të rrezikut janë miratuar nga Raiffeisen International dhe zbatohen për përdorim nga Banka.

Nga janari 2008, Banka ka vepruar në përputhje me dhe ka raportuar në bazë të kërkesave të Basel II në nivelin e Grupit që mbulon rrezikun kreditor dhe të tregut. Zbatimi i kërkesave të Basel II duhet të sigurojë një menaxhim më të mirë të kapitalit.

Mjedisi i thjeshtë financiar dhe i tregut në Kosovë lejon përdorimin e metodës së analizës të thjeshtë. Faktorët e ardhshëm më kompleks dhe rreziqet në industrinë bankare do të përkrahen nga zhvillimi i metodave të reja për t'i menaxhuar më mirë ato.

Në bazë të politikave të Bankës, totali i pasurive të Bankës klasifikohet dhe analizohet si më poshtë:

- Analiza e pasurive bazuar në klasën e pasurisë/produktit (pasuritë klasifikohen në bazë të katalogut të produkteve të Grupit);
- Analiza e pasurive bazuar në cilësinë kreditore (pasuritë klasifikohen në bazë të direktivave të Grupit);
- Analiza e pasurive në përputhje me bazën e matjes;
- Analiza e pasurive bazuar në vjetërsi, që do të thotë analiza e kryer për pasuritë që janë në vonesë por jo të rëna në vlerë;
- Analiza individuale e pasurive të përcaktuara si të rëna në vlerë nga faktorë të rënies në vlerë;
- Analiza e pasurive bazuar në llojin e kolateralit dhe duke marrë parasysh shumën që vlerësohet se do të rikuperohet;
- Analiza e pasurive bazuar në përqendrimin e rreziqeve sipas industrisë/ sektorit/ segmentit /shumës së caktuar të ekspozimit.

## 4.2 Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për Bankën nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe shfaqet kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet e bankës për klientët dhe bankat e tjera dhe investimet në letrat me vlerë. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Banka i merr në konsiderim të gjitha elementet e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor (si rreziku i mospërmbushjes së të obliguarit individual, rreziku i vendit dhe sektorit).

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj rrezikut kreditor që është rreziku që pala tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë shumat e plota në kohën e duhur. Banka i strukturon nivelet e rrezikut kreditor që i merr përsipër duke vendosur limite në sasinë e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës dhe segment gjeografik apo industrial. Rreziqet tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen rishikimit mujor ose më të shpeshtë. Limitet në nivelin e rrezikut kreditor nga huamarrësi aprovohen nga Menaxhmenti.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor menaxhohet përmes analizës së rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve potencialë për të përmbushur detyrimet e pagesës së interesit dhe kapitalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë menaxhohet, pjesërisht, me marrjen e kolateralit dhe garancive të korporatave dhe atyre personale.

Ekspozimi maksimal i Bankës ndaj rrezikut kreditor pasqyrohet kryesisht në vlerat e pasurive financiare në pasqyrën e pozicionit financiar. Ndikimi i kompensimit reciprok të mundshëm të pasurive dhe detyrimeve për të zvogëluar ekspozimin e mundshëm kreditor nuk është i rëndësishëm.

Rreziku kreditor për instrumentet financiare jashtë bilancore përcaktohet si mundësia e mbajtjes së humbjes si rezultat i asaj që një palë tjetër ndaj një instrumenti financiar nuk arrin të veprojë në përputhje me kushtet e kontratës. Banka përdor politikat e njëjta kreditore kur bën detyrimet e kushtëzuara ashtu siç bën për instrumentet financiare të bilancit nëpërmjet aprovimit të kredive të përcaktuara, limiteve të kontrollit të rrezikut dhe procedurave të monitorimit.

Banka mban lloje të ndryshme të kolateralit si siguri për rrezikun kreditor. Përveç kësaj, zbatohen metoda të tjera për përmirësimin e kreditit. Llojet kryesore të kolateralit janë të shënuara më poshtë:

- Prona (toka, ndërtesat)
- Apartamentet
- Automjetet
- Pajisjet
- Garancia personale

Vlera e kolateralit llogaritet në bazë të metodave të caktuara të cilat përfshijnë formula të standardizuara të llogaritjes së bazuar në vlerat e tregut, skontime të paracaktuara, si dhe vlerësimet e ekspertëve.

Vlerësimi dhe rivlerësimi i hipotekës është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e specialisteve të bankës, për të gjitha llojet e hipotekave. Vlerësimi i pasurive të patundshme përditësohet një herë në vit. Ky rivlerësim vjetor realizohet nga specialistët e brendshëm të kolateralit. Nëse përditësimi i rivlerësimit nuk bëhet çdo 18 muaj, atëherë vlera e hipotekës zbritet 10% për secilin vit që nuk përmban rivlerësim kolateralit. Monitorim më i shpeshtë është i nevojshëm, kur tregu i pasurive të patundshme është subjekti i ndryshimeve të rëndësishme në rrethana.

### *Kreditë dhe letrat e rëna në vlerë*

Kreditë dhe letrat e rëna në vlerë janë kredi dhe letra me vlerë për të cilat Banka konstaton se është e mundshme që nuk do të jetë në gjendje të inkasojë tërë kapitalin dhe interesin e duhur sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes së kredisë/të letrave me vlerë.

### *Kreditë e vonuara por jo të rëna vlerë*

Kredi ku interesi kontraktual ose pagesat e kapitalit janë me vonesë por Banka beson se dëmtimi nuk është llogaritur si duhet në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit në dispozicion dhe/ose fazës së arkëtimit të shumës së kredisë ndaj bankës.

### *Kreditë me kushte të ristrukturuara*

Kreditë me kushte të ristrukturuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe ku banka ka bërë lëshime të cilat nuk do të konsideronte përndryshe. Pasi kredia është ristrukturuar mbetet në të njëjtën kategori deri sa të arrihet një performancë e kënaqshme. Performanca e kënaqshme definohet si tri pagesa të njëpasnjëshme të principalit dhe/ose interesit kontraktual.

### *Shumat e lejuara për rëniet në vlerë*

Banka vendos një lejim për humbjet nga rënia në vlerë që përfaqëson vlerësimin e humbjeve që do të ndodhin të portfolionit të saj kreditor. Elementet kryesore të kësaj këtij lejimi janë një komponent i humbjes specifike që lidhet me ekspozimet individualisht të rëndësishme, dhe një lejim për humbjet e kredive kolektive të vendosur për grupet e pasurive homogjene në lidhje me humbjet që janë shkaktuar por nuk janë identifikuar në kreditë që janë subjekt i vlerësimit individual për rënie në vlerë.

### *Politika e shlyerjes*

Banka shlyen gjendjen e kredisë (dhe zbritjen për humbjet nga rënia në vlerë) kur Komiteti i Bankës për Kredi Problematike konstaton se kreditë/letrat me vlerë janë të paarkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacionit të tillë si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në situatën financiare të huamarrësit/emetuesit që huamarrësi/emetuesi më nuk mund të paguajë detyrimin, ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të kthyer të gjithë ekspozimin.

### *Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor*

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor para kolateralit dhe lehtësimeve tjera kreditorë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 është si më poshtë:

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor	Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit		Kreditë dhe paradhëniet për bankat		Kreditë dhe paradhëniet për klientët		Jo-Derivative						Derivative					
							Investimet në letra me vlerë		Investimet në vartës		Pasuri të tjera		Zotimet e lidhura me kreditë		Swapet e Normave të Interesit			
							2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015
Vlera bartëse	121,471	100,916	40,564	40,442	495,691	450,596	207,749	229,204	2,234	336	678	945	-	-	37,190	19,290		
Vlera e zotuar/garantuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	76,907	97,868	-	-
	121,471	100,916	40,564	40,442	495,691	450,596	207,749	229,204	2,234	336	678	945	76,907	97,868	37,190	19,290		
Pa vonesa dhe jo të rëna në vlerë	121,471	100,916	40,564	40,442	455,297	387,925	207,749	229,204	2,234	336	678	945	-	-	-	-		
Të vonuara por jo të rëna vlerë	-	-	-	-	27,211	48,024	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		
Të rëna në vlerë	-	-	-	-	31,865	36,289	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		
<b>Gjithsej shuma bruto</b>	<b>121,471</b>	<b>100,916</b>	<b>40,564</b>	<b>40,442</b>	<b>514,373</b>	<b>472,238</b>	<b>207,749</b>	<b>229,204</b>	<b>2,234</b>	<b>336</b>	<b>678</b>	<b>945</b>	-	-	-	-		
Lejimi për rënie në vlerë	-	-	-	-	(18,682)	(21,642)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		
Vlera bartëse neto	121,471	100,916	40,564	40,442	495,691	450,596		229,204	2,234	336	679	945	-	-	-	-		
<b>Jashë bilancore: ekspozimi maksimal</b>																		
Gjithsej zotimi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	76,907	97,868		
Provizioni	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	(32)	(32)	-		
<b>Gjithsej ekspozimi</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>76,875</b>	<b>97,836</b>	-		



## Kreditë dhe paradhëniet për klientët

Tabelat e mëposhtme shpalosin informacion në lidhje me cilësinë kreditore të asetëve financiare dhe lejimin për rënien në vlerë/ humbjen e mbajtur nga Banka kundër këtyre pasurive.

	Kreditë dhe paradhëniet për klientët	
	2016	2015
<b>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor</b>		
Shuma bruto	514,373	472,238
Lejimi për rënie në vlerë	(18,682)	(21,642)
Vlera bartëse neto	495,691	450,596
<b>Kreditë me kushte të rinegociuara</b>		
Vlera bartëse bruto	34,948	47,548
Shuma e rënë në vlerë	(10,495)	(12,324)
Vlera bartëse neto	24,453	35,224

<i>Pa vonesa dhe jo të rëna në vlerë, dhe me vonesa dhe jo të rëna në vlerë</i>				
	2016	2016	2015	2015
	<i>Pa vonesa dhe jo të rëna në vlerë</i>	<i>Me vonesa dhe jo të rëna në vlerë</i>	<i>Pa vonesa dhe jo të rëna në vlerë</i>	<i>Me vonesa dhe jo të rëna në vlerë</i>
<i>Jo-Retail</i>				
Klasifikimi 2C	3,923	-	5,456	-
Klasifikimi 3B	1,428	-	-	-
Klasifikimi 3C	-	-	779	-
Klasifikimi 4A	-	-	643	200
Klasifikimi 4B	6,968	-	24,292	171
Klasifikimi 4C	20,057	-	28,622	-
Klasifikimi 5A	32,819	-	7,839	-
Klasifikimi 5B	37,908	105	15,030	131
Klasifikimi 5C	3,311	-	9,933	7,453
Klasifikimi 6A	38,337	7,829	30,853	480
Klasifikimi 6B	20,959	1,295	4,772	2,066
Klasifikimi 6C	22,796	-	17,593	11,708
Klasifikimi 7A	5,975	144	6,425	878
Klasifikimi 7B	6,881	3,193	6,864	453
Klasifikimi 7C	2,899	12	6,073	2,139
Klasifikimi 8A	1,346	312	8,161	172
Klasifikimi 8B	1,268	2,029	2,037	487
Klasifikimi 8C	639	9	2,816	917
Klasifikimi 9A	8,714	-	-	1,528
Klasifikimi 9B	2,247	1,219	1,985	6,543
Klasifikimi 9C	1,426	-	-	150
Klasifikimi i pavlerësuar	-	-	5	-
	219,901	16,147	180,178	35,476

	2016	2016	2015	2015
	Pa vonesa dhe jo të rëna në vlerë	Me vonesa dhe jo të rëna në vlerë	Pa vonesa dhe jo të rëna në vlerë	Me vonesa dhe jo të rëna në vlerë
<b>Retail</b>				
VOLUMI I RI	1,364	2	13,984	212
AKTUALE	31,095	-	193,545	1
1-30 ditë vonesë	-	1,110	62	8,461
31-60 ditë vonesë	-	171	96	1,982
61-90 ditë vonesë	-	218	42	746
91-120 ditë vonesë	-	48	-	348
121-150 ditë vonesë	-	79	-	338
151-180 ditë vonesë	-	12	18	460
PLL (provizionet për humbjet nga kreditë bazuar në portfolio)	202,937	9,424	-	-
	235,396	11,064	207,747	12,548
<i>Individualisht të rëna në vlerë</i>				
Jo-Retail		27,358		32,447
<i>Klasifikimi 10</i>		27,358		32,447
Retail		4,508		3,841
180+		1,544		3,841
ILLP (provizionet individuale për humbjet nga kreditë)		2,964		-
<i>Lejimi për rënie në vlerë</i>				
Individual		14,777		19,777
Kolektiv		3,905		1,865
Gjithsej lejimi për rënie në vlerë		18,682		21,642

Vlerësimet kryhen veçmas për klasa të ndryshme të asetëve duke përdorur modele të klasifikimit të riskut të brendshëm. Probabilitetet e parazgjedhura të përcaktuara për klasifikimet individuale të vlerësimit janë llogaritur për secilin klasifikim veçmas. Si pasojë mundësia e parazgjedhur e të njëjtit rang rendor të vlerësimit (p.sh korporatave me vlerësim të mirë kreditor, bankat A3, sovranët A3) nuk janë drejtpërdrejtë të krahasueshme në mes të këtyre klasave të asetëve. Modelet e vlerësimit në klasat kryesore të aktiveve jo-retail - korporatat, bankat, dhe sovranë - janë uniforme në të gjitha njësitë dhe arrijnë në 27 kategori vlerësimi për klientët e korporatave dhe dhjetë kategori vlerësimi për bankat dhe sovranët. Për klasat e asetëve Retail, vlerësimet për secilin shtet janë zhvilluar në bazë të standardeve uniforme të Grupit. Vlerësimet e klientëve, si dhe validimi mbështetet nga mjete të veçanta softuerike (p.sh. mjetet e vlerësimit të biznesit, databaza e vlerësimeve dhe ekspozimeve joperformuese).

#### **Kolaterali i mbajtur dhe lehtësimet tjera kreditore**

Vlera e drejtë e kolateralit vlerësohet nga Banka mbi baza individuale. Vlera e përcaktuar paraqet vlerën e shpërndarë të ekzekutimit. Të ardhurat e pritshme nga likuidimi i kolateralit janë marrë gjithashtu parasysh në llogaritjen e zhvlerësimit individual dhe kolektiv. Më poshtë është shpalosur një analizë e kolateralit dhe lehtësimeve tjera kreditore gjatë viteve:

31 dhjetor 2016	Kreditë dhe paradhëniet për klientët			Vlera e drejtë e kolateralit		
	Retail	Korporata	Total	Retail	Korporata	Total
Pasuri të patundshme komerciale	576	5,433	6,009	456	1,765	2,221
Pasuri të patundshme residenciale	21,320	-	21,320	17,727	-	17,727
Pasuri të luajtshme	229,072	257,972	487,044	176,801	78,460	255,261
<b>Total</b>	<b>250,968</b>	<b>263,405</b>	<b>514,373</b>	<b>194,984</b>	<b>80,225</b>	<b>275,209</b>

31 dhjetor 2015	Kreditë dhe paradhëniet për klientët			Vlera e drejtë e kolateralit		
	Retail	Korporata	Total	Retail	Korporata	Total
Pasuri të patundshme komerciale	117	3,454	3,571	117	3,454	3,571
Pasuri të patundshme residenciale	17,975	-	17,975	17,933	-	17,933
Pasuri të luajtshme	206,038	244,654	450,692	186,985	219,426	406,411
<b>Total</b>	<b>224,130</b>	<b>248,108</b>	<b>472,238</b>	<b>205,035</b>	<b>222,880</b>	<b>427,915</b>

Më poshtë është paraqitur një analizë e pasurive financiare të vonuara por jo të rëna në vlerë, dhe pasuritë e rëna në vlerë:

2016						
	Gjithsej shuma e bartur bruto	Pasuritë e vonuara por jo të rëna në vlerë	Pasuritë e rëna në vlerë individualisht (gjithsej shuma e bartur)	Provizionet individuale të humbjes nga kreditë	Provizionet e humbjes nga kreditë sipas portfolit	Vlera e drejtë e kolateralit
Klientët korporata	263,410	16,147	27,358	(11,701)	(629)	80,225
Klientët e vegjël	250,963	11,064	4,507	(3,078)	(3,274)	194,984
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	514,373	27,211	31,865	(14,779)	(3,903)	275,209
2015						
	Gjithsej shuma e bartur bruto	Pasuritë e vonuara por jo të rëna në vlerë	Pasuritë e rëna në vlerë individualisht (gjithsej shuma e bartur)	Provizionet individuale të humbjes nga kreditë	Provizionet e humbjes nga kreditë sipas portfolit	Vlera e drejtë e kolateralit
Klientët korporata	248,108	35,476	32,447	(16,018)	(647)	222,880
Klientët e vegjël	224,130	12,548	3,842	(3,759)	(1,218)	205,036
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	472,238	48,024	36,289	(19,777)	(1,865)	427,916

2016	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Kreditë dhe paradhëniet për klientët me vonesa, por jo të rëna në vlerë	292	2,053	3,311	21,554	27,210
Kreditë dhe paradhëniet për klientët me vonesa dhe të rëna në vlerë	24,099	696	2,226	4,845	31,866
2015	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Kreditë dhe paradhëniet për klientët me vonesa, por jo të rëna në vlerë	1,732	4,208	18,970	23,114	48,024
Kreditë dhe paradhëniet për klientët me vonesa dhe të rëna në vlerë	22,973	4,827	3,374	5,115	36,289

Banka monitoron përqendrimin e rrezikut kreditor sipas sektorit. Analiza e përqendrimin të rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 për kreditë dhe paradhëniet për klientë me vonesa dhe të rëna në vlerë është dhënë më poshtë:

2016	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Total
Klientët korporata	23,338	484	1,413	2,123	27,358
Klientët retail	761	212	813	2,722	4,508
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	24,099	696	2,226	4,845	31,866
2015	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Total
Klientët korporata	22,522	4,695	2,855	2,375	32,447
Klientët retail	451	132	519	2,740	3,842
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	22,973	4,827	3,374	5,115	36,289

### Kreditë dhe paradhëniet për bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër për çdo ditë nga Menaxhimi i Rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare vetëm në bankat lokale apo ndërkombëtare të sigurta. Para se të iniciohet një marrëdhënie afariste me një bankë të caktuar, menaxhmenti dhe departamenti i rrezikut kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime të investimeve monitorohen vazhdimisht për vlerësimet e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Moody, Standard & Poor's (S&P) dhe Fitch.

Një funksion i pavarur nga departamenti i thesarit, zakonisht menaxhimi i rrezikut, duhet të monitorojë që ekspozimi ndaj të gjitha bankave nuk i kalon limitet rregullative ose limitet e brendshme të vendosura nga menaxhmenti i Bankës. Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ekspozim total të rrezikut kreditor ndaj palëve të lidhura që tejkalon 15% të kapitalit rregullativ të Klasit I. Kreditë dhe paradhëniet për bankat jepen pa kolateral. Tabela e mëposhtme paraqet llogaritë rrjedhëse të Bankës dhe depozitat e afatizuara në bankat korrespondente sipas rejtingut kreditor:

Më 31 dhjetor	2016	2015
AA+ to AA-	30,815	30,333
BBB+ to B-	20,401	24,945
	<b>51,216</b>	<b>55,278</b>

### 4.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare. Banka ekspozohet ndaj kërkesave të përditshme mbi burimet e saj të parave të gatshme në dispozicion nga llogaritë rrjedhëse, depozitat që u afrohet afati i maturimit, kreditë e tërhequra dhe garancitë. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nga Menaxhmenti i Bankës.

Banka mban pasuri afatmesme dhe afatgjata dhe për shkak të kushteve të tregut, financon pjesën më të madhe të portofolit të saj me borxh afatshkurtër. Në këtë proces, Banka trashëgon rrezikun e likuiditetit që lidhet me mospërputhjet e maturimit. Rreziqet nëse menaxhohen në mënyrë korrekte janë rreziqe të pranueshme. Banka lëshon pasuri afatgjata, siç janë kreditë PI dhe hipoteka, dhe këto portfolio financohen kryesisht nga depozitat me kërkesë dhe depozitat me afat deri në 1 vit. Menaxhmenti merr në baza ditore informacionin e raportit të likuiditetit të Bankës, dhe gjithashtu në baza javore pranon raportin e likuiditetit të renditur sipas segmentit të biznesit. Pasi që banka lëshon pasuri afatmesme dhe afatgjata, dhe i financon ato me borxh afatshkurtër dhe afatmesëm, ajo është e ekspozuar edhe ndaj rrezikut të normës së interesit.

Rezerva e likuiditetit rregullativ llogaritet si 10 për qind e detyrimeve mesatare që kanë afat maturimi brenda një viti, rezervë e cila mbahet si depozita në bankën qendrore dhe 50 për qind në para të gatshme fizike. Më 31 dhjetor 2016, teprica e rezervës së likuiditetit është 22.695 € (2015: € 4.181 mijë).

Tabela e mëposhtme tregon pasuritë dhe detyrimet si më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 sipas maturitetit të mbetur kontraktual. Disa nga pasuritë megjithatë, mund të jenë të natyrës më afatgjatë; për shembull kreditë vazhdojnë shpesh dhe prandaj kreditë afatshkurtra mund të ketë kohëzgjatje më të madhe.

	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Jo-specifike	Total
<b>Pasuritë</b>						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	11,476	-	-	-	109,995	121,471
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	40,564	-	-	-	-	40,564
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	26,522	51,774	157,541	259,854	-	495,691
Investimet në letra me vlerë	22,109	49,354	80,924	55,362	-	207,749
Pasuri tjera	-	-	678	-	-	678
<b>Gjithsej pasuritë financiare</b>	<b>100,671</b>	<b>101,128</b>	<b>239,143</b>	<b>315,216</b>	<b>109,995</b>	<b>866,153</b>
<b>Detyrimet</b>						
Depozitat nga klientët	707,955	1,615	4,169	11,230	-	724,969
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	511	-	-	-	-	511
Borxhi i varur	336	-	-	19,000	-	19,336
Detyrime tjera	-	-	8,007	-	-	8,007
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>	<b>708,802</b>	<b>1,615</b>	<b>12,176</b>	<b>30,230</b>		<b>752,823</b>
<b>Pozicioni neto i diferencës më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(608,131)</b>	<b>99,513</b>	<b>226,967</b>	<b>284,986</b>	<b>109,995</b>	<b>113,330</b>

	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Jo-specifike	Total
<b>Pasuritë</b>						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	14,812	-	-	-	86,104	100,916
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	40,442	-	-	-	-	40,442
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	50,014	44,137	140,126	216,319	-	450,596
Investimet në letra me vlerë	3,860	29,791	125,083	70,470	-	229,204
Pasuri tjera	-	-	945	-	-	945
<b>Gjithsej pasuritë financiare</b>	<b>109,128</b>	<b>73,928</b>	<b>266,154</b>	<b>286,789</b>	<b>86,104</b>	<b>822,103</b>
<b>Detyrimet</b>						
Depozitat nga klientët	647,066	4,404	15,289	8,440	-	675,199
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	2,202	-	-	-	-	2,202
Borxhi i varur	336	-	-	19,000	-	19,336
Detyrime tjera	-	-	5,400	-	-	5,400
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>	<b>649,604</b>	<b>4,404</b>	<b>20,689</b>	<b>27,440</b>	<b>-</b>	<b>702,137</b>
<b>Pozicioni neto i diferencës më 31 dhjetor 2015</b>	<b>(540,476)</b>	<b>69,524</b>	<b>245,465</b>	<b>259,349</b>	<b>86,104</b>	<b>119,966</b>

Analiza e maturimit të kredive për klientë bazohet në datat e mbetura të maturimit të marrëveshjeve të kredisë, që do të thotë duke marrë parasysh këstet në baza mujore.

Raportimi i likuiditetit në baza javore në nivel të segmentit të biznesit, monitorimi i raportit të pandryshueshmërisë ndaras për të gjitha segmentet e biznesit, limitet në librin bankar dhe raportet të cilat matin rrezikun e interesit dhe diferencat, janë aktualisht mjetet e zbatuara për të menaxhuar dhe kufizuar rrezikun themelor për kryerjen e biznesit.

Rezervat e detyrueshme të likuiditetit janë të përfshira në kuadër të kategorisë “me kërkesë dhe më pak se një muaj”, sepse shumica e detyrimeve me të cilat lidhet kjo gjendje janë gjithashtu të përfshira në këtë kategori.

Analiza e maturitetit për detyrimet financiare analizohet si në vijim:

- Në bazë të datës më të hershme kontraktuale të maturitetit– varianti i rastit më të keq;
- Në bazë të rrjedhave kontraktuale të parasë pa u skontuar;
- Përcaktimin e brezave kohorë;
- Rrjedhat e pritura të parasë përdoren si informata plotësuese.

Përputhja dhe/ose mospërputhja e kontrolluar e afateve të maturimit dhe normave të interesit të pasurive dhe detyrimeve është themelore për menaxhimin e Bankës. Është e pazakontë për bankat që të përputhen plotësisht pasi biznesi i kryer është shpesh me afat të pasigurt dhe i llojeve të ndryshme. Një pozicion i papërputhur potencialisht rrit profitabilitetin, por gjithashtu mund të rrisë rrezikun e humbjeve. Afati i maturimit të pasurive dhe detyrimeve dhe aftësia për të zëvendësuar detyrimet që bartin interes ndërsa ato maturojnë me një kosto të pranueshme janë faktorë të rëndësishëm në vlerësimin e likuiditetit të Bankës dhe ekspozimin e saj ndaj ndryshimeve në interes dhe kursin e këmbimit.

Banka ka një mospërputhje të konsiderueshme të afatit të maturitetit të pasurive dhe detyrimeve me afat maturimi një vit. Kjo mospërputhje e likuiditetit lind për shkak të faktit se burimi kryesor i financimit të Bankës si më 31 dhjetor 2015 ishin llogaritë e klientëve që janë sipas kërkesës dhe maturojnë brenda më pak se një muaji. Menaxhmenti beson se, përkundër asaj se një pjesë të madhe e llogarive të klientëve janë "sipas kërkesës", diversifikimi i këtyre depozitave sipas numrit dhe llojit të depozituesve do të tregonte se llogaritë e këtyre klientëve japin një burim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të financimit për Bankën.

Banka ka përmirësuar pozicionin neto përmes burimeve të tjera të financimit, të cilat ofrojnë financimin afatmesëm dhe ka për qëllim të vazhdojë përputhjen e maturitetit të pasurive me detyrimet në periudhat që do të vijjnë. Gjithashtu, Banka ka një marrëveshje të papërdorur të një mundësie për kredi, e cila do të ofrojë përkrahje në rast se ka nevojë për likuiditet. Shuma totale kontraktuese e mbetur e zotimeve për të dhënë kredi nuk paraqet domosdo kërkesa të ardhshme për para, pasi shumë prej këtyre zotimeve do të skadojnë ose përfundojnë pa u financuar.

#### 4.4 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që vlera e një investimi do të bjerë për shkak të lëvizjeve në faktorët e tregut. Katër faktorët standardë të rrezikut të tregut janë:

- Rreziku i ekuitetit ose rreziku që çmimet e aksioneve do të ndryshojnë.
- Rreziku i normës së interesit ose rreziku që normat e interesit do të ndryshojnë.
- Rreziku valutor ose rreziku që normat e valutës së huaj do të ndryshojnë.
- Rreziku i mallrave ose rreziku që çmimet e mallrave (d.m.th., drithërat, metalet etj.) do të ndryshojnë.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj rrezikut të tregut. Rreziku i tregut shfaqet nga pozicionet e hapura në normën e interesit dhe produktet valutore, të cilat të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Menaxhmenti vendos limitet në vlerën e rrezikut që mund të pranohet, që monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk i ndalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të mëdha të tregut.

#### Rreziku gjeografik

Përqendrimi gjeografik i pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës më datën 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është dhënë më poshtë:

	Kosovë	BE	Tjera	Total
<b>Pasuritë</b>				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	109,995	11,476	-	121,471
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	-	40,564	-	40,564
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	495,691	-	-	495,691
Investimet në letra me vlerë	42,031	144,430	21,288	207,749
Pasuri tjera	678	-	-	678
<b>Gjithsej pasuritë financiare</b>	<b>648,395</b>	<b>196,470</b>	<b>21,288</b>	<b>866,153</b>
<b>Detyrimet</b>				
Depozitat nga klientët	672,557	23,889	28,523	724,969
Depozitat nga bankat	256	255	-	511
Borxhi i varur	-	19,336	-	19,336
Detyrime tjera	6,369	1,638	-	8,007
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>	<b>679,182</b>	<b>45,118</b>	<b>28,523</b>	<b>752,823</b>
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>	<b>679,182</b>	<b>45,118</b>	<b>28,523</b>	<b>752,823</b>

	Kosovë	BE	Tjera	Total
<b>Pasuritë</b>				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	86,104	14,812	-	100,916
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	-	40,442	-	40,442
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	450,596	-	-	450,596
Investimet në letra me vlerë	43,052	167,565	18,587	229,204
Pasuri tjera	945	-	-	945
<b>Gjithsej pasuritë financiare</b>	<b>580,697</b>	<b>222,819</b>	<b>18,587</b>	<b>822,103</b>
<b>Detyrimet</b>				
Depozitat nga klientët	625,794	21,234	28,171	675,199
Depozitat nga bankat	972	1,230	-	2,202
Borxhi i varur	-	19,336	-	19,336
Detyrime tjera	3,840	1,560	-	5,400
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>	<b>630,606</b>	<b>43,360</b>	<b>28,171</b>	<b>702,137</b>
<b>Neto pozicioni i diferencës më 31 dhjetor 2015</b>	<b>(49,909)</b>	<b>179,459</b>	<b>(9,584)</b>	<b>119,966</b>

## Rreziku valutor

Kjo është një formë e rrezikut që vjen nga ndryshimi në çmimin e një valute kundër një tjetre. Rreziku valutor menaxhohet përmes monitorimit të pozicioneve të hapura të FX (valutës së huaj). Këto pozicione vendosen për pozicione ditore dhe gjithashtu veç e veç, për pozicionet brenda natës. Analiza e sensitivitetit i dorëzohet menaxhmentit në baza javore.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në kurset mbizotëruese të këmbimit në valutë të huaj në pozicionin e saj financiar dhe në rrjedhat e parasë. Menaxhmenti vendos limitet mbi nivelin e ekspozimit sipas valutave dhe në total, të cilat monitorohen çdo ditë. Përdorimi i euros në Kosovë dhe ekspozimi i kufizuar ndaj valutave të tjera do të thotë që ka pak nevojë për të përdorur instrumentet derivative për menaxhimin e rrezikut valutor.

Raporti i rrezikut të tregut që përfshin raportin e rrezikut të normës së interesit dhe raportin e valutës së FX të hapura dërgohet te menaxhmenti në baza javore. Raporti përkatës përgatitet nga menaxhimi i rrezikut në RBI bazuar në të dhënat që jepen nga burimet lokale të raportimit.

Tabela e mëposhtme jep përmbledhjen e ekspozimit të Bankës ndaj rrezikut të këmbimit valutor të huaj në datën 31 dhjetor 2016 dhe 2015. Përfshirë në tabelë janë pasuritë dhe detyrimet financiare të bankës në vlera të librit, të kategorizuara sipas valutës dhe të konvertuara në '000 euro.

	EUR	USD	Tjera	Total
<b>Pasuritë</b>				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	116,030	1,786	3,655	121,471
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	21,811	1,081	17,672	40,564
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	495,691	-	-	495,691
Investimet në letra me vlerë	179,260	28,489	-	207,749
Pasuri tjera	678	-	-	678
<b>Gjithsej pasuritë financiare</b>	<b>813,470</b>	<b>31,356</b>	<b>21,327</b>	<b>866,153</b>
<b>Detyrimet</b>				
Depozitat nga klientët	672,653	30,081	22,235	724,969
Depozitat nga bankat	511	-	-	511
Borxhi i varur	19,336	-	-	19,336
Detyrime tjera	8,007	-	-	8,007
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>	<b>700,507</b>	<b>30,081</b>	<b>22,235</b>	<b>752,823</b>
<b>Pozicioni neto i diferencës më 31 dhjetor 2016</b>	<b>112,963</b>	<b>1,275</b>	<b>(908)</b>	<b>113,330</b>

	EUR	USD	Tjera	Total
<b>Pasuritë</b>				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	95,338	1,666	3,912	100,916
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	16,278	7,812	16,352	40,442
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	450,596	-	-	450,596
Investimet në letra me vlerë	203,673	25,531	-	229,204
Pasuri tjera	945	-	-	945
<b>Gjithsej pasuritë financiare</b>	<b>766,830</b>	<b>35,009</b>	<b>20,264</b>	<b>822,103</b>
<b>Detyrimet</b>				
Depozitat nga klientët	620,124	32,074	23,001	675,199
Depozitat nga bankat	2,202	-	-	2,202
Borxhi i varur	19,336	-	-	19,336
Detyrime tjera	5,400	-	-	5,400
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>	<b>647,062</b>	<b>32,074</b>	<b>23,001</b>	<b>702,137</b>
<b>Neto pozicioni i diferencës më 31 dhjetor 2015</b>	<b>119,768</b>	<b>2,935</b>	<b>(2,737)</b>	<b>119,966</b>

## Analiza e sensitivitetit të valutës së huaj

Valutat e huaja ndaj të cilave Banka është e ekspozuar kryesisht janë Dollari amerikan (USD), Frangu zviceran (CHF) dhe Funta britanike (GBP). Tabela e mëposhtme jep në detaje sensitivitetin e Bankës ndaj rritjes përkatëse dhe rënies në vlerën e euros kundrejt valutave të huaja. Përqindja e përdorur është norma e sensitivitetit e përdorur kur raportohet rreziku i valutës së huaj për personelin menaxhues kryesor dhe përfaqëson vlerësimin e menaxhmentit për ndryshimin e mundshëm në normat e këmbimit të valutës së huaj. Analiza e sensitivitetit përfshin vetëm artikujt monetarë të hapur në valutë të huaj dhe korrigjon konvertimin e tyre në fund të periudhës për një ndryshim përkatës në normat valutore. Analiza e sensitivitetit përfshin plasmanet në bankat e tjera, paratë e gatshme në bankat korrespondente si dhe depozitat e klientëve, ku emërtimi i shumave është në valutë të ndryshme nga valuta e huadhënësit apo huamarrësit. Numri pozitiv më poshtë tregon rritje në fitim dhe kapital tjetër ku euro forcohet me përqindjet përkatëse kundrejt valutës përkatëse. Për dobësimin përkatës të euros ndaj valutës përkatëse, do të kishte ndikim përafërsisht të barabartë dhe të kundërt në fitim dhe kapital tjetër, dhe gjendjet më poshtë do të ishin negative.

Normat zyrtare spot (aktuale) të këmbimit të valutës për valutat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave në datën e raportimit, të denominuara në valuta të huaja, ishin si në vijim (në euro):

Krahasuar me €	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
1 USD	1.053	0.9158
1 CHF	1.073	0.9246
1 GBP	0.858	1.3605

	Dollari Amerikan (USD)		Franga Zvicerane (CHF)		Funta Britanike (GBP)	
	2016	2015	2016	2015	2016	2015
Normat e sensitivitetit	6%	7%	2%	6%	8%	4%
Fitimi dhe humbja	(69)	2,618	(954)	(8)	(44)	(989)

Sipas mendimit të menaxhmentit, analiza e sensitivitetit nuk përfaqëson rrezikun e brendshëm të këmbimit valutës sepse viti dhe ekspozimi nuk pasqyrojnë ekspozimin gjatë vitit. Transaksionet e denominuara në Dollar amerikan, Frang zviceran dhe Funta britanike nuk janë të shpeshta dhe janë vetëm për transaksionet dhe plasmanet në institucionet financiare jo të BE-së.

## Rreziku i normës së interesit

Ky është rreziku që vlera relative e një pasurie që bart interes do të humbë në vlerë. Pasuritë e Bankës janë kryesisht në kredi afatmesme dhe afatgjata, dhe detyrimet janë kryesisht depozita afatshkurtra, prandaj kjo e ekspozon bankën ndaj mospërputhjeve të normës së interesit, dhe si pasojë diferencat përkatëse e ekspozojnë Bankën ndaj lëvizjeve të normës së interesit në treg.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në bilancin e saj financiar dhe rrjedhat e parasë. Marzhat e interesit mund të rriten si rezultat i ndryshimeve të tilla, por mund të zvogëlohen ose të krijohen humbje në rast se linden lëvizje të papritura. Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit, kryesisht si rezultat i kredidhënies me norma fikse të interesit, me shuma dhe për periudha të cilat ndryshojnë nga ato të depozitave me afat me norma fikse të interesit. Në praktikë normat e interesit në përgjithësi janë fikse për kredi afatshkurtra. Menaxhmenti vendos limitet e nivelit të mospërputhjes së normës së interesit për ndryshim të çmimit që mund të ndërmerret. Sipas kontratave të kundërkëmbimit të normave të



interesit, Banka pajtohet të këmbejë dallimin ndërmjet shumës fikse dhe asaj variabile të interesit të llogaritur mbi shumat konceptuale të principalit. Paraja në dorë dhe bilanci në BQK në të cilën nuk paguhet interes janë të përfshira në kolonën "pa interes" në tabelën e mëposhtme, si dhe depozitat pa interes të klientëve. Për t'u mbrojtur për diferencat ndërmjet kredive fikse afatmesme dhe afatgjata në krahasim me ato variabile afatshkurtra dhe afatmesme, përdoret instrumenti derivativ financiar i quajtur kundërkëmbim (SEAP) i normës së interesit, ku Banka Raiffeisen në Kosovë është kryesisht paguese e anës së interesit të fiksuar, kurse pala tjetër është paguese e normës variabile, dhe ana variabile është indeksuar në EURIBOR 6 muaj, për të siguruar sensitivitet optimal.

Banka Raiffeisen në Kosovë zbaton menaxhimin aktiv të rrezikut për t'u mbrojtur kundër pozicioneve të rrezikut të tregut. Rreziku i normës së interesit është i mbrojtur pjesërisht nëpërmjet instrumenteve derivative financiare. Për të siguruar stabilitet afatgjatë në rrjedhën e parasë nga portfoliot ekzistuese të kredive, që matorojnë ndërmjet vitit 2016 deri në vitin 2029, këto pozicione janë të mbrojtura përmes kundërkëmbimit të normës së interesit. Kundërkëmbimet e normës së interesit kontabilizohen si derivativë në librin bankar pa zbatuar kontabilitetin mbrojtës. Kundërkëmbimet e normës së interesit maten me vlerën e tregut në çdo datë raportimi dhe çdo ndryshim që rezulton nga kjo njihet në fitim dhe humbje të vitit. Pozicionet maten duke përdorur metodën e vlerës së pikëve bazë.

Tabela më poshtë jep përmbledhjen e ekspozimit të bankës ndaj rrezikut të normës së interesit. Të përfshira në tabelë janë pasuritë dhe detyrimet financiare të bankës në shumat e bartura, të kategorizuara sipas ndryshimit të çmimit ose datës së maturimit, cila është më e hershme.

	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Total
<b>Pasuritë</b>						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	11,476	-	-	-	109,995	121,471
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	39,739	-	-	-	825	40,564
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	26,522	51,774	157,541	259,854	-	495,691
Investimet në letra me vlerë	22,109	49,354	80,924	55,362	-	207,749
Pasuri tjera	-	-	-	-	678	678
<b>Gjithsej pasuritë financiare</b>	<b>99,846</b>	<b>101,128</b>	<b>238,465</b>	<b>315,216</b>	<b>111,498</b>	<b>866,153</b>
<b>Detyrimet</b>						
Depozitat nga klientët	155,502	1,555	12,407	4,678	550,827	724,969
Depozitat nga bankat	255	-	-	-	256	511
Borxhi i varur	336	-	-	19,000	-	19,336
Detyrime tjera	-	-	-	-	8,007	8,007
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>	<b>156,093</b>	<b>1,555</b>	<b>12,407</b>	<b>23,678</b>	<b>559,090</b>	<b>752,823</b>
<b>Pozicioni neto i diferencës më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(56,247)</b>	<b>99,573</b>	<b>226,058</b>	<b>291,538</b>	<b>(447,592)</b>	<b>113,330</b>

Depozitat me zero interes nga klientët në shumën prej € 550 milionë janë kryesisht llogari rrjedhëse të bizneseve dhe individëve. Ato nuk kanë ndonjë ndryshim kontraktual të çmimit ose datës së maturimit, por normat e interesit do të përshtateshin në një periudhë të shkurtër kohore si përgjigje ndaj ndryshimeve në normat e interesit të tregut.

	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Total
<b>Pasuritë</b>						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	14,812	-	-	-	86,104	100,916
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	39,647	-	-	-	795	40,442
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	50,014	44,137	140,126	216,319	-	450,596
Investimet në letra me vlerë	3,860	29,791	125,083	70,470	-	229,204
Pasuri tjera	-	-	-	-	945	945
<b>Gjithsej pasuritë financiare</b>	<b>108,333</b>	<b>73,928</b>	<b>265,209</b>	<b>286,789</b>	<b>87,844</b>	<b>822,103</b>
<b>Detyrimet</b>						
Depozitat nga klientët	182,810	4,404	15,289	8,440	464,256	675,199
Depozitat nga bankat	1,230	-	-	-	972	2,202
Borxhi i varur	336	-	-	19,000	-	19,336
Detyrime tjera	-	-	-	-	5,400	5,400
<b>Gjithsej detyrimet financiare</b>	<b>184,376</b>	<b>4,404</b>	<b>15,289</b>	<b>27,440</b>	<b>470,628</b>	<b>702,137</b>
<b>Pozicioni neto i diferencës më 31 dhjetor 2015</b>	<b>(76,043)</b>	<b>69,524</b>	<b>249,920</b>	<b>259,349</b>	<b>(382,784)</b>	<b>119,9668</b>

Tabela më poshtë jep përmbledhjen e normave efektive të interesit sipas valutave kryesore për instrumentet financiare monetare kryesore. Analiza është përgatitur duke përdorur normat vjetore efektive.

Në përqindje	2016				2015			
	EUR	USD	CHF	GBP	EUR	USD	CHF	GBP
<b>Pasuritë</b>								
Plasmanet pa afat në banka tjera	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Depozitat me afat në banka tjera	(0.5)	0.4	(1.0)	0.3	(0.3)	0.1	(4.1)	0.3
Bonot qeveritare HTM	0.4	-	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Bonot qeveritare AFV	0.2	0.5	N/A	N/A	0.4	0.8	N/A	N/A
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	7.6	N/A	N/A	N/A	8.8	N/A	N/A	N/A
Kreditë tjera	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
<b>Detyrimet</b>								
Llogaritë e klientëve	0.0	0.0	(0.0)	(0.0)	0.0	0.0	-	-
Depozitat me afat	2.0	0.0	0.0	0.0	1.7	0.4	0.1	0.3
Llogaritë e kursimit	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.1

Nga perspektiva e menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit, ka dy aspekte të rrezikut:

- Vlerësimi i rrezikut
- Kontrolli i rrezikut

#### Vlerësimi i rrezikut të normave të interesit

Sensitiviteti i rrezikut të normave të interesit matet për të përcaktuar sasinë e varësisë së vlerës aktuale të një pozicioni në një faktor rreziku. Sensitivitetet e normës së interesit, shpesh të referuara si vlera të pikëve bazë (VPB), japin ndryshimin e vlerës aktuale në njësi të monedhës referuese, nën supozimin se normat e interesit ndryshojnë nga 0.01 për qind (ose 1 PB). Rreziku i normës së interesit matet duke përdorur metodën VaR (Vlerën në rrezik). Kjo metodë nënkupton një skenar matjeje ku përdoret kohëzgjatja 10 ditë dhe intervali i besueshmërisë 99 për qind. VaR matet në stresin e 1bps ndryshim në lakoren e rendimentit (yield). Ky skenar supozon implikimin në fitim dhe humbje të Bankës, në rast se lakorja e rendimentit lëviz në një drejtim apo tjetrin për një pikë bazë ose për 0.01 për qind.

Më poshtë janë paraqitur të dhënat e VPB për 2016 dhe 2015:

2016	Total	2015	Total
CHF	6	CHF	7
EUR	(13,193)	EUR	(4,338)
GBP	(11)	GBP	8
USD	(2,205)	USD	(3,632)

Vlera në rrezik më 31 dhjetor 2016 është (156) mijë euro, për 31 dhjetor 2015 (26) mijë euro.

Efekt i rrezikut të interesit në ekuitet është i ngjashëm me atë në fitim dhe humbje.

Rezultatet e analizës së sensitivitetit i paraqiten menaxhmentit në baza javore, dhe rishikohen në mënyrë të pavarur nga menaxhimi i rrezikut RZB Vjenë.

#### Kontrolli i rrezikut të interesit

Mekanizmi i kontrollit të rrezikut të normës së interesit shfrytëzohet përmes raporteve ditore të vlerës në pikë bazë (VPB). Banka aktualisht ka limitin e VPB prej 55 mijë euro. Për qëllim të matjes së VPB, produktet e normës së administruar janë modeluar duke përdorur portfolion e replikuar. Vlera e pikëve bazë matet për valutë dhe për brez kohor. Limitet vendosen edhe për çdo valutë dhe për periudha të ndryshme kohore.

#### 4.5 Rreziku operativ

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të trajtuar rrezikun operacional i është dhënë menaxhmentit të lartë në çdo njësi biznesi. Kjo përgjegjësi përkrahet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesat për barazimin dhe monitorimin e transaksioneve
- pajtueshmëria me kërkesat rregullative dhe ligjore
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave

- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për të trajtuar rrezikun e identifikuar
- kërkesat për raportimin e humbjeve operationale dhe veprimet e propozuara korrigjuese
- zhvillimi i planeve kontingjente
- trajnimi dhe zhvillimi profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- minimizimi i rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin kur kjo është efektive.

Pajftueshmëria me standardet e Bankës përkrahet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga auditimi i brendshëm. Rezultatet e kontrolleve të auditimit të brendshëm diskutohen me menaxhmentin e njësisë së biznesit të cilës i përket, ku përmbledhja i dërgohet komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të lartë të Bankës.

#### 4.6 Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

##### Kapitali rregullativ

Banka menaxhon kapitalin e saj për të siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë afarizmin duke maksimizuar kthimin për aksionarët përmes optimalizimit të baraspeshës ndërmjet borxhit dhe kapitalit. Strategjia e përgjithshme e Bankës mbetet e pandryshuar nga viti i kaluar. Struktura e kapitalit të Bankës përbëhet nga borxhi, që përfshin huamarrjet dhe ekuiteti që u takon pronarëve të kapitalit, i cili përfshin kapitalin e lëshuar dhe fitimet e mbajtura.

##### Kërkesat e kapitalit për rrezik operacional

Kërkesat e kapitalit për rrezikun operacional llogariten bazuar në rregulloren e BQK-së "për menaxhimin e rrezikut operacional", duke përdorur metodën e treguesit themelor. Sipas metodës së treguesit themelor, kërkesa për kapital për rrezikun operacional është e barabartë me 15 për qind (pesëmbëdhjetë për qind) e treguesit përkatës. Tregues përkatës është mesatarja gjatë tre viteve të shumës së të ardhurave neto nga interesi dhe të ardhurave neto jo nga interesi.

##### Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është proporcioni i kapitalit rregullator ndaj pasurive të ponderuara sipas rrezikut, zërat jashtë bilancit dhe rreziqe të tjera, i shprehur në përqindje. Raporti minimal i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 8 për qind për kapitalin e Klasit 1 dhe 12 për qind për fondet vetanake totale. Banka ka përbushur këto kërkesa rregullative gjatë vitit.

##### Pasuritë e ponderuara sipas rrezikut (RWA)

